# RAPORT

# I VLERËSIMIT TË JASHTËM PERIODIK

## Për Programin e studimit "Master Profesional" në "Menaxhim Biznesi", me profile: "Menaxhim SME-ve"; "Menaxhim i Burimeve Njerëzore dhe Karrierës"; "Institucioneve dhe Administrim Publik", ofruar nga Universiteti Europian i Tiranës


Ekspertët e vlerësimit të jashtëm:

1. Prof.Asoc. Etleva Leskaj
2. Prof.Asoc. Ana Kapaj


Korrik, 2018

## RAPORT I GRUPIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

### Për Programin e studimit Master Profesional në "Menaxhim Biznesi", me profile: "Menaxhim i SME-ve"; "Menaxhim i Burimeve Njerëzore dhe Karrierës"; "Institucioneve dhe Administrim Publik"

| | Tabela e të dhënave për programin e studimit | |
|---|---|---|
| 1 | IAL Aplikues: | Universiteti Europian i Tiranës |
| 2 | Fakulteti që e ofron | Fakulteti Ekonomik dhe i Teknologjisë së Informacionit |
| 3 | Urdhëri/VKM i licencimit/riorganizimit | VKM Nr. 74, datë 21.01.2009 |
| 4 | Urdhëri/VKA e Akreditimit të pare | Urdhër MASH Nr. 68, datë 14.02.2011 |
| 5 | Titulli i programit të studimit: | Master Profesional në "Menaxhim Biznesi", me profile: "Menaxhim SME-ve"; "Menaxhim i Burimeve Njerëzore dhe Karrierës"; "Institucioneve dhe Administrim Publik" |
| 6 | Cikli i studimit: | Cikli i dytë |
| 7 | Kohëzgjatja e programit të studimit: | 1 vit akademik* |
| 8 | Kreditet në total (ECTS): | 60 kredite (ECTS)* |
| 9 | Forma e studimit (me kohë të plotë/të pjesshme/në distancë/): | Me kohë të plotë |
| 10 | Gjuha (shqip/tjetër): | Shqip |
| 11 | Programi ofrohet nga institucioni | Po |
| 12 | Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera | Jo |
| 13 | Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin): | - |
| 14 | Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin): | - |
| 15 | Niveli në Kornizën kombëtare të kualifikimeve | Niveli 7 |
| 16 | Aktivizimi i programit të studimit | 2009-2010 |
| 17 | Numri i studenteve | 57 studentë (viti akademik: 2011-2012)<br>60 studentë (viti akademik: 2012-2013)<br>47 studentë (viti akademik: 2013-2014)<br>63 studentë (viti akademik: 2014-2015)<br>97 studentë (viti akademik: 2015-2016)<br>69 studentë (viti akademik: 2016-2017)<br>82 studentë (viti akademik: 2017-2018) |

Shenim: Tabela plotësohet nga Specialisti i ASCAL

*** Në periudhën 2010-2016, programi është ofruar me 60 ECTS dhe 90 ECTS (1 vit dhe 1.5 vite akademike). Në periudhën 2016 dhe aktualisht, programi ofrohet me 60 ECTS (1 vit akademik).**

## HYRJE

**Të dhëna për programin e studimit "Master Profesional" në "Menaxhim Biznesi" me profile; "Menaxhim i SME-ve", "Menaxhim i Burimeve Njerëzore dhe Karrierës", "Institucioneve dhe Administrim Publik"**

Programi i studimit **"Master Profesional" në "Menaxhim Biznesi"**, me profile 3 profile; **a. Menaxhim SME-ve, b. Menaxhim i Burimeve Njerëzore dhe Karrierës, c. Institucioneve dhe Administrim Publik**, ofrohet nga **Departamenti i Menaxhimit dhe Marketingut**. Ky program studimesh ka filluar si MNP me Vendim Nr. 74, dt. 21.01.2009 të Këshillit të Ministrave, *"Për hapjen e programeve të reja të studimit, të ciklit të dytë, në Shkollën e Lartë Universitare Private "Universiteti Europian i Tiranës""*,në përputhje me Ligjin e Arsimit të Lartë nr. 9741, datë 21.05.2007, *"Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë"*, i ndryshuar. Sipas Pikës 3 të këtij Vendimi, UET do të ofrojë programe të studimeve në Master i Nivelit të Parë (MNP) me së paku 60 ECTS dhe kohëzgjatje normale 1 vit. Më pas institucioni ka bërë riorganizmin e këtij programi si program i ciklit të dytë Master Profesional duke e ofruar me kohëzgjatje 1/1.5 vite akademike dhe 60/90 ECTS. Sipas Ligjit të arsimit të lartë por edhe udhëzimet përkatëse për rirorganizimin e programeve të studimit shprehet qartë që rirorganizimi i një programi studimesh me më shumë se 20 %, të kurrikulës së tij bëhet me urdhër të ministrit përgjegjës të arsimit. Nuk disponohet një urdhër i tillë dhe nuk ka një praktikë të nisur nga institucioni dhe të ndjekur nga ministria për këtë çështje. Sipas dokumetacioni të ACAL, kjo situatë i është bërë e ditur ministrisë së arsimit dhe sportit me shkresë nr. 202/1, datë 26.07.2017, dhe për dijeni gjithashtu edhe vetë institucionit. Gjithashtu është ridërguar me shkresë nr. 202/3 prot., date 30.10.2017. Kjo kërkesë ka marrë përgjigje nga MASR me shkresë drejtuar UET nr. 8571/1, ku sqarohet që ky program studimesh është përshtatur konform ligjit të arsimit të lartë të vitit 2007. Ky program studimesh është ndërtuar duke patur si qëllim nevojat e tregut të punës për specialistë të aftë në drejtim të menaxhimit të organizatave private dhe publike.

Pasi u konsultua më Rregulloren e Programit dhe bisedat me stafin, studentët dhe drejtuesit e institucionit, GVJ konstaton se në përfundim të këtij programi studimi, studenti do të jenë i aftë:

- Të ketë një formim profesional të përqëndruar në njohuritë dhe kompetencat kyçe të domosdoshme për t'i përdorur në karrierën e ardhshme.
- Të pajiset me njohuri teorike dhe praktike mbi mënyrat dhe metodat e menaxhimit të funksioneve apo veprimtarive të ndryshme të biznesit.

Për t'u pranuar në programin e studimit të ciklit të dytë, Master Profesional, studenti duhet të zotërojë së paku një diplomë të nivelit të parë (Bachelor) ose një diplomë tjetër të fituar jashtë vendit, të vlerësuar ekuivalente me të. Diploma e fituar nga studimet në ciklin e parë mund të jetë në të njëjtën fushë studimi ose në fusha të tjera të ngjashme me formimin që ofron ky program, por edhe në fusha të ndryshme. Studentët regjistrohen në këtë program studimi, pa plotësime të njohurive formuese (pa debi formimi). Afati normal i studimeve për programet e ciklit të dytë të studimeve, Master Profesional është 1 vit. Pas mbarimit të afatit të përcaktuar marrëdhënia mes Universitetit dhe Studentit rinegociohet. Numri i lëndëve që përbëjnë këtë program studimi është 6 (gjashtë) dhe ndahen në 1 lëndë të formimit të përgjithshëm (A), 3 lëndë të formimit karakterizues të programit (B), 2 lëndë në disiplina të ngjashme (bazuar në profilin e zgjedhur nga studenti). Secila nga lëndët e ndjekura ka 6 ECTS. Më pas studentët ndjekin praktikën profesionale dhe mbrojnë punimin e diplomës. Planet mësimore janë nën vëzhgim të vazhdueshëm dhe kanë qënë subjekt i ndryshimeve.

Sipas RVB, misioni i UET është t'u japë studentëve një edukim cilësor, duke përkthyer në të rezultatet e një kërkimi shkencor të vlefshëm, t'i shërbejë dijes së shoqërisë shqiptare nëpërmjet mësimdhënies, kreativitetit, përdorimit të arritjeve më të mira të shkencës, si dhe ndërtimit të partneriteteve me tregun e punës e atyre ndërkombëtare.

## GRUPI I VLERËSIMIT TË JASHTËM (GVJ)

Përbërja e GVJ:

1. Prof. Asoc. Etleva Leskaj
2. Prof. Asoc. Ana Kapaj

Gjatë gjithë procesit të vlerësimit GVJ u asistua nga Kordinatori Teknik i ASCAL, znj. Emisa Isufaj. Më datë 24.06.2018, përmes sistemit AMS dhe me shkresë zyrtare me Nr. 25/43 Prot., datë 26.06.2018 me lëndë "Njoftim për dërgimin e draft – Raporteve të vlerësimit të jashtëm", Universiteti Europian i Tiranës është njohur me Draft-Raportin e Vlerësimit të Jashtëm. Më datë 29.06.2018, UET përcjell nëpërmjet sistemit AMS në ASCAL "*Komentet ne lidhje me draft-Raportin e Vleresimit te Jashtem_MP Menaxhim Biznesi*", ndërsa me shkresë Nr.10/35 Prot., datë 29.06.2018 me lëndë "*Dërgohen komentet në lidhje me draft-Raportet Draft Raporteve të Vlerësimit të Jashtëm për programet e studimit Master Profesional*" ato sillen zyrtarisht. GVJ pasi lexoi me kujdes komentet e IAL, vendosi të rikonfirmojë analizën dhe konkluzionet e nxjerra në draft-Raport. Si përfundim, Raporti i Vlerësimit të Jashtëm **nuk u ndryshua**.

## ANALIZË PËR PLOTËSIMIN E REKOMANDIMEVE TË DHËNA NGA KA NË VENDIMIN PËR AKREDITIMIN E PARË

**I. Rekomandimet e Këshillit të Akreditimit**

a) Departamenti duhet të shohë me përparësi kompletimin me staf mësimdhënës që zotëron të paktën gradën Doktor.
b) Të vazhdohet puna e nisur, sidomos me universitetet anglo saksone.
c) Të hartohet një plan kërkimi shkencor që reflekton kërkesat aktuale të biznesit dhe të administratës publike
d) Kurikulat mësimore duhet të përcaktojnë qartë literaturën bazë të detyruar, pasi në disa lëndë ajo është e mbingarkuar
e) Të pasurohet fondi i bibliotekës në veçanti me titujt e përfshirë në kurrikuat mësimore të lëndëve.

**II. Plotësimi i tyre nga Institucioni**

a) Nga shqyrtimi i dokumentacioni të ofruar si dhe mbështetur në vizitën në institucion, është vënë re se UET ka rekrutuar staf të brendshëm në vitet e fundit duke patur si qëllim kryesor rritjen akademike të tij. Për këtë arsye në rekrutimet e reja kanë thithur staf që zotërojnë gradën shkencore Doktor. GVJ konstatoi të paktën 3 rekrutime të reja gjatë 2-vjeçarit të fundit me doktoratura në Universitete perëndimore. Gjithashtu në vetë politikat e institucionit vihet re një stimulim i stafit aktual për tu regjistruar dhe vazhduar shkollën doktorale, pranë UET apo dhe jashtë duke akorduar periudha disa mujore kërkimi shkencor të paguar. Një ndihmesë në këtë drejtim për pedagogët që kanë 5 vite punë në UET, është se ata gëzojnë të drejtën të përfitojnë semestrin sabatik të paguar. Për rekomandimin ***"Departamenti duhet të shohë me përparësi kompletimin me staf mësimdhënës që zotëron të paktën gradën Doktor"***, institucioni ka punuar dhe **plotësuar** këtë rekomandim

b) UET ka marëveshje bashkëpunimi në kuadër të projekteve Tempus, Jean Monnet, Erasmus+, si edhe si dhe me institucioneve të tjera në kuadër të programeve mbështetëse për kërkimin shkencor nga donatorë të ndryshëm ndërkombëtar dhe lokal si Agjencitë e UN, Assist Impact/USAID, American-Albanian Development Fund, Fondacioni Shoqëria e Hapur, Regional Research Promotion Programme; NUFFIC, Sëiss Development Cooperation, etj. Universiteti Europian i Tiranës, ka marrëveshje bashkëpunimi me shumë universitete jashtë vendit ku mund të përmendim, "La Sapienza" University of Rome, University of Padova, University of Bari, University of Bolonja Itali; Central European University, Budapest; si dhe disa universitete kombëtare. Sidomos në kuadër të marëveshjeve ERASMUS+, UET ka realizuar një serë mobilitetesh në staf (mësimdhënie dhe trajnim) dhe në studentë. Për rekomandimin ***"Të vazhdohet puna e nisur, sidomos me universitetet anglo saksone"***, institucioni e ka **plotësuar** këtë rekomandim.

c) UET ka miratuar në instancat e tij drejtuese, Senatin Akademik, Planin e Këkimit Shkencor në UET 2017-2020 si pjesë e dokumentacionit të institucionit. (*Dokument plotësues nr. 2, gjatë vizitës në IAL*). Për rekomandimin ***"Të hartohet një plan kërkimi shkencor që reflekton kërkesat aktuale të biznesit dhe të administratës publike"***, institucioni e ka **plotësuar** këtë rekomandim.

d) Në Broshurën së Dokumenteve UET, në ciklin e dytë të studimeve parashikohet që literatura për çdo lëndë duhet të mbështetet në 2-3 tekste bazë dhe 10-15 materiale si literaturë e rekomanduar. GVJ konstaton se kjo literaturë është e përshtatshme duke marrë parasysh ciklin e studimeve, në të cilin njohuritë dhe aftësitë e studentëve nevojitet të avancohen dhe thellohen. Për rekomandimin ***"Kurikulat mësimore duhet të përcaktojnë qartë literaturën bazë të detyruar, pasi në disa lëndë ajo është e mbingarkuar"***, institucioni e ka **plotësuar** këtë rekomandim.

e) Lidhur me rekomandimin e dhënë për pasurimin e fondit të Bibiotekës, GVJ nga inspektimi në terren konstatoi se institucioni ka punuar në drejtim të plotësimit të këtij kriteri. Fondi i bibliotekës është mjaft i pasur me literaturë në pëputhje me kurrikulën e programit të studimit, megjithatë institucioni duhet të punojë në vazhdimësi për pasurimin e vazhdueshëm të saj. Për

rekomandimin ***"Të pasurohet fondi i bibliotekës në vecanti me titujt e përfshirë në kurrikulat mësimore të lëndëve"***, institucioni e ka **plotësuar** këtë rekomandim.

## 1. Misioni/Objektivat e programit të studimit

**Pjesa përshkrimore**

> **Terma reference**: Qëllimet dhe objektivat e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor, strategjitë afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata, ndjekja dhe përshtatja e objektivave dhe e qëllimeve me kohën, të dhëna të përgjithshme për IAL.

Misioni i UET është t'u japë studentëve një edukim cilësor, duke përkthyer në të rezultatet e një kërkimi shkencor të vlefshëm, t'i shërbejë dijes së shoqërisë shqiptare nëpërmjet mësimdhënies, kreativitetit, përdorimit të arritjeve më të mira të shkencës, si dhe ndërtimit të partneriteteve me tregun e punës e atyre ndërkombëtare, referuar Statutit të UET dhe RVB

Programi i studimit "Master Profesional" në "Menaxhim Biznesi" (*në vijim MPMB*), përbëhet nga tre profile; "Menaxhim SME-ve", "Menaxhim i Burimeve Njerëzore dhe Karrierës", si dhe "Institucioneve dhe Administrim Publik". Programi i studimit MPMB ofrohet nga Departamenti i Menaxhimit dhe Marketingut, pranë Fakultetit të Ekonomisë dhe Teknologjisë së Informacionit, në UET. Ky program studimesh ka filluar si MNP me Vendim Nr. 74, dt. 21.01.2009 të KM, në përputhje të Ligjit të Arsimit të Lartë Nr. 9741, datë 21.05.2007. PS MPMB është ndërtuar duke patur si qëllim nevojat e tregut të punës për specialistë të aftë në drejtim të menaxhimit të organizatave private dhe publike dhe jofitimprurëse.

Referuar RVB, si edhe informacionit të marrë, gjatë vizitës në institucion, objektivi kryesor i PS MPMB, është transmetimi te studentët i njohurive të nevojshme teorike e veçanërisht praktike dhe aplikative në kuadër të manaxhimit të bizneseve të mëdha , të mesme e të vogla, organizatave të ndryshme të shërbimit, agjencive turistike e të transportit, mediave të shkruara dhe atyre vizive, manaxhimit të institucioneve shëndetësore dhe arsimore, analizës së politikave të organizatve publike në nivel qendror dhe lokal, manaxhimit të organizatave jofitmprurëse, etj. Ndër objektivat e PS MPMB, është edhe tejçimi i njohurive në fushat e Manaxhimit të Burimeve Njerëzore, Sjelljes organizative si dhe Legjislacionit të punës.

Veprimtaria e UET-it bazohet në Ligjin Nr. 80/2015, datë 22.07.2015 *"Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë"*, si dhe të akteve të tjera nënligjore mbi arsimin e lartë, të Statutit të Universitetit, Rregullores Bazë të tij dhe të akteve të tjera rregullatorë të institucionit. UET-i fillimisht u krijua si Shkollë e Lartë Universitare Jopublike me Vendimin Nr. 636, datë 20.09.2006 të Këshillit të Ministrave *"Për dhënien e lejes për hapjen e Shkollës së Lartë Universitare Jopublike "Universiteti Europian i Tiranës""*, si dhe të Programeve të Studimit të Ciklit të Parë. Në vijim të aktivitetit të tij, UET është akredituar institucionalisht me Urdhër të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës Nr. 246, datë 24.07.2009, *"Për akreditimin institucional të Shkollës së Lartë Universitare Private "Universiteti Europian i Tiranës"*, dhe ndërsa me Urdhër Nr. 68, datë 14.02.2011, UET-i është akredituar për programet e ciklit të dytë "Diplomë e Nivelit të Dytë", "Master i Nivelit të Parë" dhe "Master i Nivelit të Dytë". Me VKM nr. 657, datë 28.09.2011, *"Për ndryshimin e emërtimit, nga Shkolla e Lartë Universitare, Jopublike, "Universiteti Europian i Tiranës", në Universiteti Europian i Tiranës"*, është ndryshuar emërtimi i institucionit. UET i është nënshtruar procesit të vlerësimit të jashtëm institucional, i finalizuar me Vendimin e Bordit të Akreditimit (BA), Nr. 12, datë 07.04.2017 *"Për akreditimin periodik të Institucionit të Arsimit të Lartë "Universiteti Europian i Tiranës"*.

**Vlerësimi sipas Standardeve**

| Standardi/Kriteret | Vlerësimi sipas standardeve[1] |
|---|---|

[1] GVJ duhet të shprehen me shkrim për çdo standard në mënyrë të përmbledhur (mbështetur në kriteret majtas). Në fund të çdo rubrike, grupi duhet të japë mendimin e tij për përmbushjen e standardeve në tërësi.

| Standardi I.1 - Institucioni ofron programe studimesh në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij. | |
|---|---|
| **Kriteri 3** Programet e studimeve hartohen në përputhje me misionin dhe qëllimin e institucionit;<br>**Kriteri 4** Programet e studimeve hartohen në përputhje me nevojat e tregut të punës;<br>**Kriteri 5** Programet e studimeve hartohen në përputhje me zhvillimin ekonomik të vendit;<br>**Kriteri 6** Programet e studimeve pasqyrojnë vullnetin e institucionit për ruajtjen e vlerave kulturore të kombit. | GVJ konstaton se PS MPMB, pranë Universitetit Europian të Tiranës, është hartuar në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit.<br><br>GVJ, referuar RVB si dhe informacionit te marrë gjatë vizitës në institucion, vlerëson se PS MPMB, hartohen në përputhje me nevojat e tregut të punës. Në këtë kuadër shërben edhe programi 250+ që synon të kuptojë nevojat e tregut dhe përshtatja e kurrikulave në përputhje me to. *(Dokumenti nr. 1: Studim Alumni, vizita në institucion)*<br><br>PS MPMB me profile, është hartuar në përputhje me zhvillimin ekonomik të vendit në tre fusha kryesore, Menaxhim SME-ve, Menaxhim i Burimeve Njerëzore dhe Karrierës, si dhe Institucioneve dhe Administrim Publik. Ekonomia shqiptare, fokusohet me së shumti në bizneset e vogla dhe të mesme, të cilat kanë domosdoshmëri manaxhimin e tyre ne mënyrë profesionale, nëpërmjet burimeve njerëzore të afta dhe të përgatitura profesionalisht.<br><br>PS MPMB, pasqyron vullnetin e institucionit për ruajtjen e vlerave kulturore të kombit. |
| **Standardi I.2 - Programet e studimeve janë në përputhje me strategjinë për zhvillim të institucionit.** | |
| **Kriteri 1** Programet e studimeve janë përshtatur me strategjinë për zhvillim të institucionit; | GVJ referuar këtu dokumentit të planit strategjik, siguruar nga vizita në institucion, konstaton se PS në MPMB, me profile, është në përputhje me strategjinë e institucionit dhe prioritetet e këtij plani si kërkimi shkencor, procesi mësimor, prioritetet në sferën e botimeve dhe materialit akademiko-pedagogjik, Prioritetet në marrëdhëniet me studentët dhe jetën studentore *(Dokumenti nr. 5: Plani Strategjik 2015-2020, vizita në institucion)* |
| **Standardi I.3 - Programet e studimeve ofrohen në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi.** | |
| **Kriteri 1** Përmbatja e programeve të studimeve është në përputhje me kriteret e përcaktuara nga aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi;<br>**Kriteri 2** Emërtimi i programit të studimit është në përputhje me nivelin e kualifikimit të arritur dhe të përcaktuar nga Korniza Shqiptare e Kualifikimit. | GVJ vlerëson se përmbatja e programit të studimit MPMB, me 3 profile, është në përputhje me kriteret e përcaktuara nga aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi. Programi zbaton kërkesat e akteve rregullatore të UET, në formën e rregulloreve dhe udhëzimeve të përgjithshme dhe specifike për programin. *(Dokumenti nr. 6: Rregullore e programit të studimit MP, dosja e vetëvlerësimit)*<br><br>Emërtimi i PS MPMB pranë UET, është në përputhje me orientimet e Kornizës Shqiptare të Kualifikimit. Emërtimi i këtij programi reflekton edhe fushën specifike të kualifikimit dhe specializimit të studentit, duke qenë se është e specifikuar edhe ndarja në 3 profile. |

| **Standardi I.11 - Institucioni harton një plan zhvillimi të programeve të studimeve, të rezultateve të mësimdhënies dhe të të nxënit.** | |
|---|---|
| **Kriteri 1** Institucioni harton një plan strategjik në nivel institucioni për zhvillimin dhe përmirësimin e programeve të studimeve;<br>**Kriteri 2** Institucioni harton një plan strategjik në nivel institucioni për përmirësimin e rezultateve të mësimdhënies dhe të të nxënit. | Sipas informacionit të siguruar, nga takimi i GVJ me strukturat drejtuese të UET, ka një plan strategjik në nivel institucioni. Ndër prioritetet strategjike të UET është ndërtimi i kurrikulave në përputhje me eksperiencën më të mirë të universiteteve perëndimore, kërkesave të "Kartës së Bolonjës", përshtatjen e tyre me ndryshimet social-ekonomike dhe zhvillimet e tregut. UET cilëson si prioritet strategjik rritjen e vazhdueshme të cilësisë së formimit të studentëve, duke u ofruar atyre dijet, metodat dhe teknikat më bashkëkohore të mësimdhënies dhe duke nxitur të qenin proaktiv e kritik *(Dokumenti nr. 5: Plani Strategjik 2015-2020, fq 4; Dokumenti nr. 55: Strategjia e mesimdhenies UET, vizita në institucion)* |

**Konkluzionet e vlerësimit:**

- UET, ofron programe studimesh në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij.
- Programi i studimit "Master Profesional" në "Menaxhim Biznesi" me profile; "Menaxhim SME-ve", "Menaxhim i Burimeve Njerëzore dhe Karrierës", si dhe "Institucioneve dhe Administrim Publik", është në përputhje me strategjinë për zhvillim të institucionit.
- Programi i studimit MPMB, me profile, ofrohet në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi.
- UET harton një plan zhvillimi të programeve të studimeve, të rezultateve të mësimdhënies dhe të të nxënit.

GVJ bazuar në dokumentacionin e ofruar nga institucioni, vizitat në institucion dhe informacionin shtesë të siguruar gjatë këtyre vizitave, konkludon se **standardet e kësaj fushe janë plotësuar**.

## 2. Struktura akademike e Fakultetit (departamentit përgjegjës për programin e studimit)

### Pjesa përshkrimore

**Terma reference**: përbërësit e njësisë dhe stafet e tyre, kompetencat, Baza e të dhënave të njësisë, freskimi i vazhdueshëm i saj dhe përgjegjësitë e mbajtjes dhe dhënies së informacionit

Fakulteti Ekonomik dhe i Teknologjisë së Informacionit, pranë UET, përbëhet nga tri Departamente;

- Departamenti i Financës dhe Ekonomiksit
- Departamenti i Matematikës, Informatikës dhe Statistikës
- **Departamenti i Menaxhimit dhe Marketingut**

Aktualisht, Fakulteti Ekonomik dhe i Teknologjisë së Informacionit ofron 3 programe studimi të Ciklit të Parë (BA); 3 programe studimi të Ciklit të Dytë Master i Shkencave (MSH), 5 programe të Ciklit të Dytë Master Profesional (MP) dhe 1 program të Ciklit të Tretë (Doktoraturë).

Referuar të dhënave (*Shtojca, Tabela 2.2, siguruar nga RVB*);

për vitin akademik **2017-2018**, ky fakultet ka në përbërje 82 pedagogë si personel akademik, nga të cilët 52 të brendshëm, 29 me grada e tituj, dhe 30 personel akademik joefektiv, dhe;

për vitin akademik **2016-2017** (*Shtojca, Tabela 2.1, siguruar nga RVB*), fakulteti ka në përbërje 83 pedagogë, nga të cilët 45 staf akademik efektiv, 25 me grada e tituj, dhe 38 staf akademik joefektiv.

Vihet re një **rritje me 16% e stafit efektiv** në vitin akademik **2017-2018**, si dhe një **zvogëlim prej 21% e stafit akademik joefektiv**.

Ne të dy vitet akademike, **stafi akademik efektiv me tituj dhe grada**, përbënte **56%** të stafit efektiv të fakultetit. Për vitin akademik 2017-2018, **64% janë staf i brendshëm**.

Personeli akademik joefektiv përbëhet nga 30 anëtarë, nga të cilët, 63% janë me tituj dhe grada. Stafi akademik me grada, përbën 59% të stafit akademik të Fakultetit Ekonomik dhe të Teknologjisë së Informacionit.

Në këtë Fakultet ndjekin studimet 54.5% e studentëve të programeve Bachelor të UET-it, rreth 53.4% e studentëve që ndjekin studimet në programet Master i Shkencave dhe 71% e studentëve që ndjekin studimet në programet Master Profesional që ofron universiteti.

Sipas të dhënave të siguruara nga RVB dhe nga vizitat në institucion, në vitin 2016-2017 **numri i studentëve që ndjekin programet MP është rritur me 54% krahasuar me 2014-2015**, ndërsa numri i studentëve që ndjekin studimet **MSH ka pësuar rënie në masën rreth 13%**. Konkretisht **për programin MPMB**, **numri i studentëve** që kanë ndjekur studimet **në vitin akademik 2016-2017, është 59% më e lartë**, **krahasuar me** numrin e studentëve që ndiqnin këtë program studimi në vitin **2014-2015**.

**Vlerësimi i Treguesve të matshëm:**

- ☑ Fakulteti, Organizimi hierarkik i Fakultetit
  Fakulteti Ekonomik dhe i Teknologjisë së Informacionit, pranë UET, përbëhet nga tri Departamente: Departamenti i Menaxhimit dhe Marketingut, Departamenti i Financës dhe Ekonomiksit, Departamenti i Informatikës, Matematikës dhe Statistikës. Secili nga departamentet ka në përbërjen e tij disa Grup–lëndë të cilat përgjigjen për përmbajtjen e lëndëve të përafërta. GVJ referuar kësaj strukture, mendon se kjo strukturë është në funksion të plotë të programit të studimit, të përmbushjes së objektivave si dhe të implementimit të strategjisë që institucioni ka për këtë programi studimi *(Dokumenti nr. 9: Organograma e UET, dosja e vetëvlerësimit)*
- ☑ Struktura akademike e Fakultetit
  Struktura akademike e fakultetit, paraqitet ne Tabelat 2.1 dhe 2.2 në shtojcë, ku jepen të dhëna për vitet akademik, 2016-2017 dhe 2017-2018.

| Standardi/Kriteret | Vlerësimi sipas standardeve |
|---|---|
| **Standardi II.2 - Institucioni organizohet në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi, për përmbushjen e misionit të tij.** | |
| **Kriteri 1** Institucioni organizohet në mënyrë që të përmbushë misionin e tij;<br>**Kriteri 2** Institucioni ka së paku dy Fakultete;<br>**Kriteri 3** Fakulteti organizohet në njësi bazë. Çdo fakultet ka, së paku, tri të tilla, nga të cilat dy departamente;<br>**Kriteri 4** Fakulteti ose Instituti i Kërkimit dhe Zhvillimit përbëhet nga, së paku, 3 njësi bazë me objektiva dhe mision të mirëpërcaktuar;<br>**Kriteri 5** Departamenti duhet të ketë në përbërje të tij të paktën 7 anëtarë efektivë si personel akademik, ndër të cilët të paktën 3 duhet të jenë me gradën shkencore "Doktor". | Struktura organizative e UET mbështet plotësimin e misionit të institucionit.<br><br>UET në përbërje të tij ka 3 Fakultete, Fakulteti Ekonomik dhe IT, Fakulteti i Shkencave Sociale dhe Edukimit, dhe Fakulteti Juridik.<br><br>Çdo fakultet është i organizuar në njësi bazë. Fakulteti Ekonomik dhe IT, që mbulon edhe programin e studimeve "Master Profesional" në "Menaxhim Biznesi", me profile, është i organizuar në 3 Departamente.<br><br>Gjithashtu referuar strukturës organizative të UET, edhe Fakulteti i Shkencave Sociale dhe Edukimit, në përbërje të tij ka 3 departamente, ndërsa Fakulteti Juridik në 2 Departamente dhe |

| | |
|---|---|
| | 1 Qendër kërkimore. *(Dokumenti nr. 9: Organograma e UET, dosja e vetëvlerësimit)*<br><br>GVJ nga shqyrtimi i dokumentacionit, i RVB, si dhe vizitës në institucion vlerëson se, personeli akademik i tre njësive bazë të Fakultet Ekonomik dhe IT, i përgjigjet kërkesave ligjore. Referuar informacionit të siguruar gjatë vizitës në institucion *(Tabela 2.2, shtojca)*, në përbërje të **Departamentit të Menaxhimit dhe Marketingut** që është përgjegjës për këtë program studimi Master, per vitin **2017-2018 13 anëtarë** si **personel akademik efektiv**, prej të cilëve **6 të kategorisë "Profesor", 5 me gradën "Doktor" dhe 2 "Master i Shkencave" dhe 6 anëtarë PAK,** ndër të cilët **1 i kategorisë profesor, 4 mbajnë gradën doktor dhe 1 pa gradë** , ndërsa gjatë 2016-2017, kanë qenë **12 anëtarë PAE dhe 5 PAK. Personeli akademik efektiv,** ka pasur në përbërje **5 anëtarë të kategorisë profesor, 4 mbajnë gradën doktor dhe 3 pa titull/grade. Personeli akademik me kontratë** gjatë këtij viti akademik, përbëhej nga **1 anëtarë i kategorisë profesor dhe 4 anëtarë mbajnë gradën doktor.** |
| **Standardi II.3 - Njësitë e institucionit angazhohen drejtpërdrejt dhe me përkushtim për realizimin e programeve të studimeve.** | |
| **Kriteri 1** Njësitë bazë dhe kryesore janë të ndërgjegjshme për përgjegjësitë që kanë për realizimin e programeve të studimeve;<br>**Kriteri 2** Njësitë bazë dhe kryesore përfshihen në procesin e rekrutimit të personelit akademik të nevojshëm dhe në vlerësimin e tij. | Nga vizita në institucion dhe informacioni i siguruar nga takimet me drejtues të njësisë kryesore dhe njësisë bazë, rezulton se këto struktura janë të ndërgjegjëshme për realizimin e programit të studimit MPMB. Veprimtaria e fakultetit dhe e secilit prej departamenteve të Fakultetit Ekonomik dhe IT, realizohet duke u mbështetur në aktet rregullative të UET *(Dokumenti nr. 9: Statuti, neni 15; Dokumenti nr. 11: Rregullorja UET, dosja e vetëvlerësimit)*<br><br>GVJ konstaton nga informacioni i siguruar në takimin me përgjegjësen e mëparshme të departamentit si dhe me përfaqësuesen e zyrës së Burimeve Njerëzore, se njësia bazë dhe kryesore përfshihen në procesin e rekrutimit të personelit akademik të nevojshëm. Përgjegjësi i departamentit rezulton anëtar i komisionit të rekrutimit, të personelit të ri akademik, referuar praktikave të rekrutimit të konsultuara nga GVJ gjatë vizitës në institucion. Departamenti propozon profilin e nevojshëm të kandidatit për plotësimin e vendit vakant, në përputhje me ngarkesën mësimore që duhet të plotësohet. Gjithashtu sipas intervistave me drejtues të fakultetit dhe departamentit, por edhe nga RVB, një nga komponentët e vlerësimit të performancës së personelit akademik të departamentit, është edhe vlerësimi i përgjegjësit |

| | |
|---|---|
| | të departamentit. Kjo përfshin kryesisht korrektesën e tij në respektimin e orarit të punës, zhvillimin e mësimit, dhe përmbushjen e detyrimeve të tjera akademike, si edhe cilësinë e mësimdhënies në auditor. *(Dokumenti nr. 19, Vizita në institucion)* |

**Konkluzionet e vlerësimit:**

- UET organizohet në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi, për përmbushjen e misionit të tij
- Struktura organizative e UET mbështet plotësimin e misionit të institucionit
- UET në përbërje të tij ka 3 Fakultete. Fakulteti Ekonomik dhe IT, që mbulon edhe programin e studimeve MPMB, me profile, është i organizuar në 3 departamente
- Personeli akademik i tre njësive bazë të Fakultet Ekonomik dhe IT, i përgjigjet kërkesave ligjore
- Njësitë e institucionit angazhohen drejtpërdrejt dhe me përkushtim për realizimin e programeve të studimeve. Njësia kryesore dhe bazë, përgjegjëse për PS MPMB, janë të ndërgjegjshme për përgjegjësitë që kanë për realizimin e programit të studimit dhe përfshihen në procesin e rekrutimit të personelit akademik të nevojshëm dhe në vlerësimin e tij.

GVJ bazuar në dokumentacionin e ofruar nga institucioni, vizitat në institucion dhe informacionin shtesë të siguruar gjatë këtyre vizitave, konkludon se **standardet e kësaj fushe konsiderohen të plotësuara.**

## 3. Personeli akademik dhe personeli mbështetës për programin e studimit

**Pjesa përshkrimore**

**Terma reference**: Të dhëna për kualifikimin e Personelit akademik, ndarja e tij në Personel Akademik Efektiv (PAE) dhe Personel Akademik me Kontratë (PAK), Personel Administrativ (PA), raporti PAE/PAK, raportet: Personel akademik/Personel administrativ/student; nevojat për Personel akademik/ administrativ, shpërndarja e ngarkesës për personelin akademik, marrëdhëniet me strukturat e tjera jashtë kohës së punësimit, kriteret e rekrutimit të personelit akademik, etj.

GVJ referuar vizitës në institucion dhe azhornimit të të dhënave, konstatoi se ky fakultet ka në përbërje të tij, një personel akademik të përbërë nga 82 pedagogë, nga të cilët 52 personel akademik efektiv dhe 30 personel akademik me kontratë. Nga personeli akademik efektiv 29 janë me tituj/grada. Përsa i përket Departamenti të Menaxhimit dhe Marketingut, për vitin akademik 2016-2017 dhe 2017-2018; në përbërje të tij janë 18 pedagogë në **2017-2018**, nga të cilët, **13** pedagogë, janë **personel akademik efektiv**, dhe gjatë **2016-2017**, **12** pedagogë janë **personel akademik efektiv**.

Për sa i përket kualifikimit të stafit të departamentit; 11 Anëtarë të personelit akademik efektiv, janë me **tituj dhe grada** për vitin **2017-2018**, pra **85%** e **stafit akademik efektiv**, ndërsa për **2016-2017**, kjo normë është **75%**.

Personeli administrativ, organizohet në nivel universiteti.

Referuar infomacionit të siguruar nga takimet, gjatë vizitës në institucion si dhe RVB, personeli akademik dhe drejtuesit akademikë kryejnë veprimtari të mësimdhënies, të kërkimit shkencor ose të aplikuar, shërbime për zhvillimin e UET-it, këshillim për studentët, tutoriat dhe detyra administrative, sipas përcaktimeve në Statutin e UET-it dhe Kontratës së lidhur mes tyre dhe UET-it.*(Dokumenti nr. 13: Kontrata për PAE; Dokumenti nr. 14: Kontrata për PAK, dosja e vetëvlerësimit)*

Personeli akademik ndahet në personel të punësuar me kohë të plotë dhe me kohë të pjesshme. Personeli akademik i punësuar me kohë të plotë është me kontratë me afat ose pa afat, dhe përbëhet

nga drejtuesit, personeli akademik i brendshëm dhe pedagogët senior. Personeli akademik i punësuar me kohë të pjesshme, përbëhet nga personeli akademik i jashtëm, pedagogët senior dhe lektorët e ftuar.

Përzgjedhja e anëtarëve të personelit akademik, si dhe vlerësimi i performancës së tyre rregullohet me dispozitat ligjore në fuqi, me dispozitat përkatëse në Statutin e UET-it dhe me dokument të veçantë. Departamenti pas një analize të kapaciteteve dhe ngarkesave, konstaton nevojën për personel të ri akademik, paraqet propozimin për rekrutim personeli akademik në Këshillin e Fakultetit qe ka funksionuar. Propozimi përmban profilin profesional të personelit akademik, që propozohet të rekrutohet, si dhe argumentimin e këtij propozimi, dhe në varësi të ngarkesës që pritet të mbulojë, nëse nevojitet pedagog i brendshëm ose i jashtëm.

Kriteret kryesore mbi të cilat mbështetet rekrutimi i kandidaturave, janë treguesit e performancës së kandidatëve, të tillë si:

a) Përvoja në mësimdhënie në nivel universitar;

b) Të ketë së paku gradë shkencore PhD ose Doktor, si dhe tituj Profesor, Profesor i Asociuar, Akademik;

c) Cilësia dhe standardet e universitetit ku është diplomuar kandidati, duke i dhënë përparësi universiteteve perëndimore;

d) Rezultatet personale të kandidatit;

e) Aktiviteti kërkimor e botues dhe përputhshmëria e tij me objektivat shkencorë të UET-it;

f) Motivet kryesore për t'u bërë pedagog në UET;

g) Aftësitë komunikuese dhe etika;

h) Objektivat e tij afatmesëm dhe afatgjatë në karrierën akademike e shkencore;

i) Përvoja e punësimit dhe rekomandimet e punëdhënësve të mëparshëm;

j) Zotërimi i gjuhëve të huaja dhe shkalla e përdorimit të tyre;

k) Paraqitja gjatë intervistës nga komisioni i posaçëm i rekrutimit;

l) Paraqitja gjatë leksionit të hapur para Departamentit përkatës.

**Vlerësimi i Treguesve të matshëm:**

☑ Numri i Personelit Akademik Efektiv (PAE) dhe Personelit Akademik me Kontratë (PAK), titujt/gradat.

Te dhënat për personelin akademik dhe me kontratë paraqiten në Tabelat 3.2 dhe 3.3, shtojca bashkëlidhur. Referuar këtyre Tabelave;

- për vitin **2017-2018**, personeli akademik i përfshirë në programin e studimit "Master Profesional" në "Menaxhim Biznesi", me profile, përbëhet nga 10 pedagogë, nga të cilët **6 janë staf akademik efektiv dhe 4 staf akademik joefektiv.**
- Ndërsa për vitin **2016-2017**, nga 10 pedagogë të përfshirë në mësimdhënie, **5 janë staf efektiv, dhe 5 janë staf akademik joefektiv**.
- Për vitin **2015-2016** përbërja e stafit akademik që mbulon këtë program studimi ka qënë respektivisht 10 anëtarë, ku **5 janë PAE dhe 6 janë PAK**,
- për **2014-2015** janë 10 anëtarë të stafit akademik, nga të cilët **6 janë PAE dhe 4 janë PAK**.
- Për vitin **2013-2014**, janë 12 anëtarë të stafit akademik nga të cilët **9 PAE dhe 3 PAK**,
- për **2012-2013** janë 9 anëtarë të stafit akademik nga të cilët **5 PAE dhe 3 PAK**, dhe,
- për vitin **2011-2012** janë 11 anëtarë të stafit akademik, nga të cilët **8 PAE dhe 3 PAK**.

Referuar këtij informacioni,

- **60%** e stafit të përfshirë në këtë program studimi, gjatë **2017-2018**, përbëhet nga **stafi akademik efektiv**,
- ndërsa gjatë **2016-2017**, kjo normë është **50%**,
- për **2015-2016**, **50%** janë PAE,
- për **2014-2015**, **60%** janë PAE,
- për **2013-2014**, **53%** janë PAE,
- për **2012-2013**, **75%** janë PAE dhe
- për **2011-2012**, **56%** e stafit të përfshirë në këtë program studimesh, është PAE.

Gjatë serisë kohore 2012-2018, vetëm gjatë vitit 2012-2013, stafi efektiv ka qenë mbi 70%. Për gjithë vitet e tjera kjo normë ka qenë në intervalin 50%-60%.

Përsa i përket qëndrueshmërisë së stafit, GVJ referuar përbërjes së stafit akademik që përfshihet në mësimdhënie në këtë program studimesh, për periudhën 2012-2017, konstaton se nga pikëpamja sasiore, numri i këtij stafi është në intervalin 10-12 anëtarë. Përsa i përket qarkullimit të stafit, referuar analizës së tabelave 3.3 në shtojcë, GVJ konstaton se norma e qarkullimit të stafit për periudhën 2012-2017 ka qenë si vijon,

- për vitin **2016-2017, 40%,**
- për vitin **2015-2016, 20%,**
- për vitin **2014-2015, 30%,**
- për vitin **2013-2014, 57%,**
- për vitin **2012-2013**, kjo normë ka qënë **35%** dhe
- për vitin **2011-2012**, norma e qarkullimit ka qënë **31.5%.**

**Norma mesatare e qarkullimit të stafit** për këtë periudhë është **35,6%**. Nga analiza e bërë më sipër GVJ, konkludon se gjatë periudhës për të cilin bëhet akreditimi i programit, në raport me qëndrueshmërinë në përbërje të këtij stafi, norma e qarkullimit dëshmon për nivele të larta të qarkullimit të tij, që arrijnë deri në 57% dhe për qëndrueshmëri të ulët. UET duhet të ndjekë politika që të rrisin qëndrueshmërinë e stafit në këtë program studimi në të ardhmen.

☑ Këshilli Shkencor i Programit të studimit dhe Koordinatori i programit të studimit

Të dhënat për këshillin shkencor të programit të studimit MPMB, me profile, paraqiten në tabelën 3.5, shtojca bashkëlidhur. Referuar tabelës 3.5, Këshilli Shkencor i programit te studimit MPMB, me profile, përbëhet nga 3 pedagogë që janë staf efektiv dhe që i përkasin kategorisë "Profesor". Kryetari i këshillit shkencor të programit të studimit MPMB, është përgjegjësi i njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit MPMB.

☑ Të dhënat sipas kualifikimit dhe Raportet midis tyre

Të dhënat për kualifikimin e stafit dhe raportet midis tyre paraqiten në Tabelën 3.4, shtojca bashkëlidhur. 100% e Stafit të përfshirë në këtë program studimi, gjatë vitit 2014-2015, 2015-2016, 2016-2017, 2017-2018 *(Tabela 3.4)* janë me tituj ose grada.

Gjatë vitit 2011-2012, 80 % e stafit të angazhuar i përket kategorisë "Profesor" ose mbajnë gadën "Doktor",

- për 2012-2013, 88% dhe,
- për 2013-2014, 91% kanë tituj ose gradë shkencore.
- Për 2014-2015, 40% e stafit akademik të përfshirë në këtë program studimi janë me tituj dhe 60% kanë gradë shkencore.
- Gjatë vitit 2015-2016, 30% e stafit akademik të përfshirë në këtë program studimi janë me tituj dhe 70% kanë gradë shkencore.
- Gjatë vitit 2016-2017, 40% e stafit, përfshirë në këtë program studimi, i përket kategorisë "Profesor", dhe 60% kanë gradën "Doktor".
- Për vitin akademik 2017-2018, 60% e stafit i përket kategorisë "Profesor", dhe 40 % kanë gradën "Doktor".

☑ Të dhëna sipas moshës së personelit

Të dhëna për përbërjen moshore të stafit akademik, të përfshirë në këtë program studimi, paraqiten në *Tabelën 3.6 në shtojcë*. Referuar tabelës 3.6 për vitin 2017-2018, 100% e stafit efektiv janë nën moshën 55 vjeç dhe 50% e stafit joefektiv, janë nën moshën 45 vjec dhe 50% janë në intervalin 55-65 vjeç.

☑ Kontratat e punës, njohja me detyrat dhe të drejtat

GVJ referuar dokumentacionit të vetëvlerësimit të dorëzuar nga institucioni, informacionit të siguruar nga shqyrtimi i dosjeve të stafit, konstaton se punonjësit akademikë në UET, punësohen me kontrata me afate të pacaktuara ose të caktuara. Kontrata e punës përmban identitetin e palëve, vendin e punës, përshkrimin e përgjithshëm të punës, kohëzgjatjen e kontratës, kohëzgjatjen e pushimeve të paguara; afatin e njoftimit për zgjidhjen e kontratës, elementet përbërëse të pagës, kohën normale javore të punës. Nga vizita në institucion, GVJ konstatoi se gjatë 2017-2018, kontrata e punë s kishte ndryshuar. (*Dokumenti nr. 13, nr. 14, dosja e vetëvlerësimit; Dokumenti nr. 28, vizita në institucion*)

**Vlerësimi sipas Standardeve**

| Standardi/Kriteret | Vlerësimi sipas standardeve |
|---|---|
| **Standardi II.1 - Personeli akademik, ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ angazhohen për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve.** | |
| **Kriteri 1** Personeli akademik, ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ i institucionit angazhohen në përputhje me objektivat e programeve të studimeve dhe për arritjen e tyre;<br>**Kriteri 2** Personeli akademik, ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ i institucionit angazhohen në përputhje me strategjinë për zhvillim të institucionit. | GVJ, bazuar mbi RVB, takimet me stafin akademik të programit dhe nga informacioni i siguruar gjatë vizitës në institucion vëren se, personeli akademik, ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ i institucionit angazhohen në përputhje me objektivat e programeve të studimeve dhe për arritjen e tyre<br><br>Ky personel akedemik angazhohet në përputhje me strategjinë për kërkim shkencor të institucionit. Përvec procesit mësimdhënies ata janë të angazhuar në përfshirjen në konferenca shkencore dhe në botime *(Dokumenti nr. 3:* |

| | |
|---|---|
| | *Komunikimi mbi Hartimin dhe Miratimin e Strategjisë së Kërkimit Shkencor në UET, Vizita në institucion)* |
| **Standardi II.4 - Personeli akademik angazhohet në hartimin dhe zbatimin e politikave të zhvillimit të institucionit.** | |
| **Kriteri 1** Personeli akademik luan rol kryesor në hartimin e kurrikulës dhe në vendimet institucionale që i përkasin organizimit të programeve të studimeve;<br>**Kriteri 2** Rekrutimi i personelit të ri dhe përcaktimi i ngarkesës mësimore bëhet në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi. | Bazuar në informacionin e siguruar në vizitën inspektuese në institucion, çdo titullar lënde, ka të drejtën dhe njëkohësisht detyrimin që të ndërtojë syllabusin e çdo lënde të planit mësimor si dhe të propozojë ndryshimet e nevojshme për përmirësim e vazhdueshëm të lëndës. GVJ konstaton se në nivel departamenti, trajtohen dhe diskutohen problematikat dhe nxitet përmirësimi i programeve dhe kurrikulës. *(Dokumenti nr. 34: Mbledhje Departamenti Menaxhim & Marketing 11.04.2017, Vizita në institucion)*<br><br>Bazuar në nevojat e institucionit dhe të programit të studimit, rekrutimi i personelit dhe caktimi i ngarkesave mësimore respektive synon të bëhet në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi. *(Dokumenti nr. 45: Ngarkesa e personelit MP M. B. nga 2011, Vizita në institucion)* |
| **Standardi III.1 - Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente për rekrutimin dhe vlerësimin e personelit.** | |
| **Kriteri 1** Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente për rekrutimin e personelit në përputhje me statutin dhe rregulloren;<br>**Kriteri 2** Personeli akademik i punësuar me kohë të plotë në programet e studimeve të ciklit të dytë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë përbën së paku 70% të personelit akademik të angazhuar për realizimin e programeve respektive të studimeve;<br>**Kriteri 3** Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente të vlerësimit të personelit;<br>**Kriteri 4** Institucioni mban një bazë të dhënash të raporteve të rekrutimit të personelit, të njoftimeve për vende vakante, etj. | Mbështetur mbi informacionin e siguruar në takimet me ish-drejtues të njësisë bazë dhe kryesore, të pranishëm në takim, dhe me përfaqësuesen e zyrës së burimeve njerëzore, GVJ konstaton se UET ndjek procedura ligjore dhe transparente për rekrutimin e personelit në përputhje me Statutin dhe Rregulloren. *(Dokumenti nr. 9: Statuti; Dokumenti nr. 11: Rregullorja UET, dosja e vetëvlerësimit)*<br><br>Referuar informacionit të siguruar gjatë vizitës në institucion, (Tabela 8.1, shtojcë), personeli akademik i punësuar me kohë të plotë në programin e studimeve MPMB, me profile, përbën mbi 80% të personelit akademik të angazhuar për realizimin e programit të studimit, për vitin 2017-2018. Ky angazhim sipas profileve, është 90% në profilin Menaxhim SME-ve; 80% në profilin "Menaxhim i Burimeve Njerëzore dhe Karrierës"; dhe 80% në profilin "Institucione dhe Administrim Publik". Për vitin 2016-2017, është 80% në profilin Menaxhim SME-ve; 70% në profilin "Menaxhim i Burimeve Njerëzore dhe Karrierës"; dhe 80% në profilin "Institucione dhe Administrim Publik". Për vitin akademik 2012-2013, kjo normë është 73% - 87% sipas profileve për vitin akademik 2013-2014 është nga 87% - |

| | |
|---|---|
| | 93%, për vitin akademik 2014-2015 është nga 80% -93% dhe për vitin 2015-2016, 80% -87%.<br><br>Gjatë vizitës në institucion GVJ identifikoi praktika të ndryshme të vlerësimit të personelit, si vlerësimi nga studentët, nga drejtuesi i njësisë bazë si dhe vetëvlerësimi. Forma të tilla vlerësimi u konstatuan të depozituara në dosjet personale të stafit, pranë burimeve njerëzore. *(Dokumenti nr. 15, dosja e vetëvlerësimit; Dokumenti nr. 7, Vlerësimi i pedagogëve)*<br><br>GVJ konstatoi se institucioni, disponon një bazë të dhënash të raporteve të rekrutimit të personelit, të njoftimeve në ëeb-in, ose në revistën "Mapo", për vende vakante, etj. Dokumentacioni lidhur me proçesin e rekrutimit dhe seleksionimit (komisioneve të intervistimit, vlerësimit të kandidatëve dhe njoftimeve për punë, dosjeve të aplikantëve) depozitohet dhe mbahet në Zyrën e Burimeve Njerëzore dhe Zyrën e Arkivit.<br><br>GVJ, në këtë bazë të dhënash identifikoi mungesa në informacion, si vendosja e mesatareve të niveleve të ndryshme të studimeve për kandidatët, që konsiderohet një informacion i rëndësishëm në seleksionimin e tyre dhe vendimarrjen nga komisionet e rekrutimit, si dhe mungesën e procedurës së rekrutimeve të vitit 2017-2018, për këtë njësi bazë. *(Dokument nr. 11 "Praktikë e rekrutimit të stafit akademik", gjatë vizitës në IAL; Dokumeni nr. 66: Takimi me përfaqësues të zyrës së Burimeve Njerëzore).* |
| **Standardi III.2 - Personeli akademik (me grada shkencore dhe tituj akademikë) mbulon nevojat e institucionit dhe i ka të përcaktuara qartë përgjegjësitë.** | |
| **Kriteri 1** Përgjegjësi i programit ka të paktën titullin "Profesor i asociuar" ose, gradën shkencore "Doktor" ("PHD") të fituar pranë universiteteve perëndimore dhe përvojë akademike në këto universitete;<br>**Kriteri 2** Titullari i lëndës/modulit në programet e studimeve "Master i Shkencave" ka të paktën gradën shkencore "Doktor";<br>**Kriteri 3** Titullari dhe pedagogët e lëndës/modulit në programet e studimeve "Master profesional" ka të paktën gradën shkencore "Doktor" ose, diplomën "Master Profesional" ose "Master Shkencash" dhe një përvojë profesionale së paku 5-vjeçare në profesionin në të cilin ofrohet ky program studimi;<br>**Kriteri 4** Rektori, zv/rektori, drejtori dhe zv/drejtori i qendrës ndëruniversitare, dekani, zv/dekani, drejtori, përgjegjësi i departamentit, përgjegjësi i shërbimit, përgjegjësi i programit janë të punësuar me kohë të plotë në institucionin që ofron programin e studimeve; | Përgjegjësi i programit studimi ka gradë shkencore dhe titull Prof. Asoc. Dr. dhe ka përvojë akademike dhe profesionale disa vjeçare.<br><br>Referuar informacionit të azhornuar pas vizitës në institucion, për 2017-2018, se 60% e titullarëve të lëndëve në programin e studimeve MPMB, me profile, i përkasin kategorisë "Profesor", dhe 40% mbajnë gradën "Doktor" *(Tabela 3.4 shtojca).*<br><br>Të gjithë drejtuesit në strukturën organizative, Rektori, Zv/Rektori, Dekani, Përgjegjësi i Pepartamentit dhe i programit, janë të punësuar me kohë të plotë në UET. *(Dokumenti nr. 10: Organograma, dosja e vetëvlerësimit)* |

| | |
|---|---|
| **Kriteri 5** Institucioni siguron personel të mjaftueshëm për udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e praktikave profesionale. | Referuar vizitës në institucion, UET, siguron personel për udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e praktikave profesionale. |
| **Standardi III.5 - Studentët që ndjekin programet e studimeve të ciklit të dytë "Master i Shkencave" apo programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë kanë udhëheqës për tezën.** | |
| **Kriteri 1** Studentët që ndjekin këto programe studimesh kanë një udhëheqës për punën kërkimore dhe tezën që përgatisin për marrjen e diplomës në përfundim të studimeve të këtij cikli;<br>**Kriteri 2** Udhëheqësi ka të paktën gradën shkencore "Doktor";<br>**Kriteri 3** Udhëheqësi nuk mbikëqyr më shumë se 5 (pesë) studentë njëkohësisht për temat me karakter kërkimor të aplikuar (si ato të ofruara në programet e studimeve në fushat e shkencave të natyrës, shkencave mjekësore, etj.) dhe më shumë se 10 (dhjetë) studentë njëkohësisht për temat e ofruara në programet e studimeve në fushat e shkencave shoqërore e humane. | GVJ konstatoi se çdo student që ndjek këtë program studimi zgjedh dhe i caktohet një udhëheqës për punën e tij kërkimore dhe për temën e diplomës që duhet të përgatisë për të përfunduar studimet e këtij cikli. Udhëheqësi ka të paktën gradën shkencore "Doktor". Studentët informohen për fushat e ekspertizës së pedagogëve përkatës për të mundësuar një përputhje sa më të mirë të temës së tyre me ekspertizën e pedagogut udhëheqës.<br><br>Nga dokumentet e siguruar nga vizita në institucion, udhëheqësit kanë një numër të lartë studentësh në udhëheqje, nga 18-24 studentë. Referuar vetëm këtij programi studimi, stafi udhëheq deri në 16 studentë të programit të studimit MPMB. Ky numër i lartë sjell mbingarkesë të stafit dhe ulje të produktivitetit të tyre. UET duhet të gjejë zgjidhje të tjera, të cilat do të rrisnin përdorimin optimal të burimeve njerëzore si, staf të jashtëm në udhëheqje të diplomave por edhe rritje të numrit të pedagogëve të brendshëm. *(Dokumenti nr. 12 – 13: Diplomat e miratuara sipas studentëve dhe pedagogëve, Vizita në institucion)* |
| **Standardi III.6 - Fusha studimore-kërkimore në të cilën është specializuar udhëheqësi është në përputhje me fushën studimore në të cilën ofrohet programi i studimit dhe është parashikuar të përgatitet teza.** | |

| | |
|---|---|
| **Kriteri 1** Fusha studimore-kërkimore në të cilën është specializuar udhëheqësi është në përputhje me fushën studimore në të cilën ofrohet programi i studimit.<br>**Kriteri 2** Udhëheqësi ka njohuri të avancuara teorike dhe aftësi të veçanta kërkimore në fushën në të cilën ofrohet programi i studimeve dhe në të cilën është parashikuar të hartohet teza. | Nga të dhënat që iu vendosën GVJ në dispozicion, vërehet se pedagogët e angazhuar në këtë program studimi janë të specializuar në një fushë studimore-kërkimore të njëjtë apo në përputhje me fushën studimore të këtij programi studimi.<br><br>Këta pedagogë zotërojnë njohuri dhe aftësi të avancuara teorike dhe kërkimore në manaxhim biznesi dhe orientojnë punën e tyre të studentit për temën e diplomës. *(Dokumentet nr. 22 – 23: Fushat e ekspertizës, Vizita në institucion)* |
| **Standardi III.7 - Institucioni angazhon personel ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ për përmbushjen e misionit të tij.** | |
| **Kriteri 1** Institucioni dëshmon një angazhim optimal të personelit ndihmës mësimor-shkencor për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbatjen e laboratorëve e mjediseve shkollore;<br>**Kriteri 2** Institucioni dëshmon një përdorim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve të ciklit të dytë. | Nga informacioni i siguruar nga vizita në institucion, rezulton se personeli ndihmës mësimor-shkencor, është në shërbim të studentëve dhe personelit akademik për të siguruar mbarëvajtjen e proçesit akademik, përfshi kordinatorin e masterit, sekretarinë, personelin e Zyrës së IT-së. Gjithashtu pranë institucionit funksionon zyra e programeve master si dhe zyra e kujdesit ndaj studentit, që synojnë krijimim e marrëveshjeve dhe partneriteteve me organizata të ndryshme në treg, si dhe për të krijuar bashkëpunime për punësimin dhe përfshirjen e studentëve të UET në to. *(Dokumenti nr. 68: Takimi me Zyrën e Kujdesit ndaj Studenteve)* |
| **Standardi III.8 - Personeli akademik realizon ngarkesën mësimore të përcaktuar në aktet ligjore e nënligjore në fuqi.** | |
| **Kriteri 1** Personeli akademik realizon ngarkesën mësimore të përcaktuar në aktet ligjore e nënligjore në fuqi;<br>**Kriteri 2** Ngarkesa mësimore e zhvilluar nga personeli akademik në programet e studimeve të ciklit të dytë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë dhe organizimi e drejtimi i tyre, vlerësohen me orë mësimore. | GVJ, referuar RVB por edhe takimeve në institucion rezulton se, pedagogët me grada e tituj duhet të plotësojnë ngarkesën fillimisht në ciklin e dytë dhe të tretë. Referuar ngarkesës së 2016-2017, rezultojnë raste kur stafi akademik i sapo rekrutuar, mbulon 5 lëndë të ndryshme, të shpërndara në nivelin Bachelor dhe Master. Gjithashtu sugjerohet, që në shpërndarjen e ngarkesës, të respektohet fusha e ekspertizës dhe e kualifikimit të stafit akademik. Referuar evidencës së shpërndarjes së ngarkesës për vitin 2017-2018, rezulton se stafi i ri akademik, mbulon 4 lëndë, që i përkasin fushës së manaxhimit dhe të financës. Përgjithësisht stafi akademik që nuk mban pozicione drejtuese mbulon 4 lëndë në programe të ndryshme.<br>Referuar evidencës së ngarkesës që raportohet nga institucioni për gjithë vitet për të cilat bëhet akreditimi pas vizitës në institucion, rezulton se |

| | |
|---|---|
| | ngarkesa mësimore e zhvilluar nga personeli akademik në programin e studimeve MPMB, vlerësohen me orë mësimore sipas koeficinteve përkatës. |
| **Standardi III.9 - Institucioni disponon një bazë të dhënash për personelin e tij.** | |
| **Kriteri 1** Institucioni disponon një bazë të dhënash të hollësishme për anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit;<br>**Kriteri 2** Institucioni disponon për secilin semestër listën e plotë të personelit akademik, të personelit ndihmës mësimor-shkencor dhe personelit administrativ;<br>**Kriteri 3** Institucioni përcakton dhe publikon kriteret dhe procedurat për rekrutimin e personelit akademik. | UET, disponon një bazë të dhënash të plotë dhe që azhornohet vazhdimisht në lidhje me stafin akademik të përfshirë në programin MPMB<br>UET, disponon për çdo semestër listën e stafit akademik dhe mbështetës, që do të angazhohet në këtë program.<br>UET, ka të përcaktuara kriteret për rekrutimin e stafit, kritere këto që publikohen në mediat e shkruara apo në ëeb sitin e institucionit<br>GVJ gjatë vizitës në institucion iu vendosën në dispozicion, informacionet për kriteret e këtij standardi, si lista e stafit akademik të përfshirë, por edhe lista e kritereve dhe praktika të publikimit në ëeb të kritereve të pranimit. *(Dokumenti nr. 11: Praktika e rekrutimit të stafit akademik, Vizita në institucion)* |

**Konkluzionet e vlerësimit:**

- Personeli akademik, ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ, angazhohen për përmbushjen e objektivave të programit të studimit "Master Profesional" në "Menaxhim Biznesi", me profile.
- Personeli akademik angazhohet në hartimin dhe zbatimin e politikave të zhvillimit të institucionit.
- UET ndjek procedura ligjore dhe transparente për rekrutimin dhe vlerësimin e personelit.
- Personeli akademik i ka të përcaktuara përgjegjësitë.
- Studentët që ndjekin programin e studimit "Master Profesional" në "Menaxhim Biznesi", me profile, kanë udhëheqës për tezën.
- Fusha studimore-kërkimore në të cilën është specializuar udhëheqësi është në përputhje me fushën studimore, në të cilën ofrohet programi i studimit dhe është parashikuar të përgatitet teza.
- UET angazhon personel ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ për përmbushjen e misionit të tij.
- Stafi efektiv mbulon mbi 70 % të ngarkesës në programin e studimit "Master Profesional" në "Menaxhim Biznesi", me profile.
- GVJ, identifikoi në dokumentacionin e rekrutimit, mungesa në informacion, si vendosja e mesatareve të niveleve të ndryshme të studimeve për kandidatët, që konsiderohet një informacion i rëndësishëm në seleksionimin e tyre
- Numri i lartë i studentëve/pedagog në udhëheqje temash, sjell mbingarkesë të stafit dhe ulje të produktivitetit të tyre. UET duhet të gjejë zgjidhje alternative, të cilat do të rrisnin përdorimin optimal të burimeve njerëzore si, staf të jashtëm në udhëheqje të diplomave por edhe rritje të numrit të pedagogëve të brendshëm.
- GVJ konstaton, raste ku stafi akademik mbulon 5 lëndë, të shpërndara në nivelin Bachelor dhe Master, ndërkohë që përgjithësisht stafi mbulon 4 lëndë të ndryshme, në nivele të ndryshme. Institucioni të vlerësojë mundësinë e uljes së numrit të lëndëve që mbulon çdo pedagog, për të kijuar një përdorim optimal të burimeve njerëzore, por edhe për të krijuar një ekuilbër mes objektivave të mësimdhënies, kërkimit shkencor dhe aktiviteteve administrative që stafi mbulon.
- Gjithashtu sugjerohet, që në shpërndarjen e ngarkesës, të respektohet fusha e ekspertizës dhe e kualifikimit të stafit akademik, pasi GVJ konstaton raste ku stafi akademik me formim manaxherial mbulon lëndë të fushës së manaxhimit dhe të financës.
- GVJ, konkludon se gjatë periudhës për të cilin bëhet akreditimi i programit norma e qarkullimit dëshmon për nivele të larta të qarkullimit të këtij stafi, që arrijnë deri në 57%

dhe për qëndrueshmëri të ulët. Norma mesatare e qarkullimit për periudhën e akreditimit është 37%. UET duhet të ndjekë politika që të rrisin qëndrueshmërinë e stafit në këtë program studimi në të ardhmen.
- Rritja e numrit të studenteve në vite, numri i lartë i lëndëve që mbulon stafi, numri i lartë i udhëheqjeve të diplomave, qarkullimi i lartë i stafit, nevoja për rritjen e përputhshmërisë mes fushës së ekspertizës dhe disiplinave që mbulon stafi, sjellin nevojën e rritjes se numrit të personelit akademik efektiv të njësisë bazë përgjegjëse për këtë program studimi.

GVJ bazuar në dokumentacionin e ofruar nga institucioni, vizitat në institucion dhe informacionin shtesë të siguruar gjatë këtyre vizitave , i konsideron **standardet e kësaj fushe, pjesërisht të plotësuara**

## 4. Infrastruktura në funksion të programit të studimit, logjistika dhe shërbime të tjera ndaj komunitetit

**Pjesa përshkrimore**

**Terma reference**: mjediset, infrastruktura, teknologjitë e informacionit, biblioteka, shërbime të tjera për studentët, residencat.

Universiteti Europian i Tiranës ndodhet me seli në adresën: Bulevardi "Gjergj Fishta", Nd. 70, H1, Tiranë. Referuar RVB, sipërfaqja totale e godinave të Universitetit është rreth 10,000 $m^2$. Përreth godinave, ndodhet një hapësirë e gjerë për lulishte me stola të jashtëm, si dhe vend për parkim për rreth 120 makina. Objekti është i pajisur me dy palë shkallë, nga të cilat, në rast emergjence në njërin krah të godinës, mundet të përdoret shkalla tjetër. Gjithashtu, godinat janë të pajisura me mjetet e nevojshme për mbrojtjen kundra zjarrit si edhe sistemin e mbrojtjes kundër shkarkesave atmosferike, përkatësisht rrufe-pritëse.

UET ka në dispozicion tre godina:

1- Godina A është e përbërë nga 4 kate, ku çdo kat ka një sipërfaqe prej 1000$m^2$.

2- Godina B është e përbërë nga 4 kate, ku çdo kat ka një sipërfaqe prej 1000$m^2$.

3- Godina C (biblioteka) gjithsej 300 m2.

UET ka aktualisht në përdorim 33 salla leksionesh dhe seminaresh si dhe 4 laboratorë mësimorë informatike, të pajisur me 175 kompjutera.

Biblioteka ka 150 vende leximi dhe 14 kompjutera. Për realizimin e të gjithë programeve të studimeve, biblioteka zotëron rreth 6005 tituj të disponushëm për studentët e të gjitha niveleve

Ambientet universitare të UET, janë të mbuluara me sinjal ËiFi.

Referuar RVB si dhe takimeve me student të programit të studimit MPMB, me profile, si dhe me stafin akademik, rezulton se UET ka implementuar sisteme informacioni, të cilat e mbështesin studentin në procesin mësimor si MOODLE (UET LMS). Sistemi bën të mundur që studenti në kohë reale, të azhornohet me materialet e hedhura nga pedogogu, leksione, materiale shtesë audio vizive etj. Studentët kanë mundësi të komunikojnë nëpërmjet sistemit në forume të hapura me pedagogët si dhe me studentët e tjerë; të informohen për vlerësimet etj.

**Vlerësimi i Treguesve të matshëm:**

☑ Mjediset për Programin e studimit

Të dhëna për mjediset ne dispozicion të programeve të studimit që UET ka paraqiten në tabelën 4.1, në shtojcën bashkëlidhur. Mjediset janë në nivel institucioni dhe referuar tabelës 4.1, institucioni dëshmon se ka infrastrukturën e duhur në dispozicion të programeve të studimit, të përbërë nga 19

salla leksionesh, 14 klasa seminaresh, sallë për njësinë bazë që mbulon këtë program studimesh, zyrë për përgjegjegjësin e njësisë bazë etj. Të gjitha klasat mësimore janë pajisur me pajisjet audio vizive të nevojshme për zhvillimin normal të proçesit mësimor. Ato janë të pajisura me videoprojektorë, sistemi fonie, si dhe me sistem kondicionimi. GVJ vlerëson se kjo infrastrukturë, është e përshtatshme për zhvillimin e procesit mësimor dhe të aktiviteteve të tjera mbështetëse për programin e studimeve.

☑ Mjediset për stafin:

Referuar RVB dhe vizitës në ambjentet e institucionit, rezulton se:

- Zyra për dekanin/zv.dekanin/kancelarine janë 5 me nga $20m^2$.
- Zyra për sekretarinë mesimore janë 3 me sipërfaqe $140m^2$.
- Zyra për stafin akademik dhe administrativ janë 12 me sipërfaqe $350m^2$.
- Mjedise për aktivitetet e qeverisë studentore janë 3 me sipërfaqe $140m^2$.

**<u>Vlerësimi sipas Standardeve</u>**

| **Standardi/Kriteret** | **Vlerësimi sipas standardeve** |
|---|---|
| **Standardi II.5 - Institucioni siguron infrastukturën e nevojshme për realizimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe të programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë që ofron.** | |
| **Kriteri 1** Institucioni ka një vendndodhje të përhershme, që nënkupton mjedis qendror administrativ dhe mjedis ku zhvillohet veprimtaria mësimore;<br>**Kriteri 2** Këto mjedise janë në dispozicion të institucionit për jo më pak se 6 vjet;<br>**Kriteri 3** Nëse programi i studimit ofrohet në më shumë se një godinë, institucioni siguron menaxhim efikas dhe kontroll të vazhdueshëm për arritjen e standardeve dhe zbatimin e politikave arsimore të hartuara për realizmin e programeve të studimeve që ofron;<br>**Kriteri 4** Institucioni garanton kapacitete dhe mjedise të mjaftueshme për realizimin e praktikave profesionale të parashikuara për realizimin e programeve të studimeve në fushat e shëndetësisë, veterinarisë, bujqësisë, shkencave teknike, etj. | UET ndodhet në Blv. "Gjergj Fishta". Gjatë vizitës në institucion, GVJ konstatoi një infrastrukturë komode e përbërë nga dy godina, lehtësisht të aksesueshme për zhvillimin normal të mësimit.<br>Ambjentet rezultojnë të jenë marrë me qera deri në fund të kësaj dekade.<br>UET rezulton se garanton, ambiente bashkëkohore, në raportin 5.9 $m^2$/student (Master), të pajisura me teknologjinë e duhur në mbështetje të mësimdhënies e ndihmuar kjo, edhe prej faktit që mësimi në ciklin e parë të studimeve zhvillohet nga e hëna në të premte, 9:00-16:00, ndërsa në programet Master, mësimi zhvillohet ditëve të javës nga ora 17:00 – 20.00 dhe të shtunave 9:00 – 16:00. Kjo shpërndarje siguron një përdorim optimal të infrastrukturës. |
| **Standardi V. 1- Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën e tij.** | |
| **Kriteri 1** Institucioni siguron tekste mësimore cilësore dhe literaturë ndihmëse të mjaftueshme dhe bashkëkohore;<br>**Kriteri 2** Në bibliotekë ka literaturë të mjaftueshme që e ndihmon studentin për për realizimin me sukses të programit të studimit, të projektit kërkimor shkencor dhe për përgatitjen e tezës;<br>**Kriteri 3** Në bibliotekë ka botime periodike dhe librari elektronike, të cilat përmbajnë libra apo revista shkencore të nevojshme për realizimin me sukses të programit të studimit, të projektit kërkimor shkencor dhe për përgatitjen e tezës;<br>**Kriteri 4** Përgjegjësit e programit kanë hartuar një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës | GVJ referuar edhe informacionit të siguruar gjatë vizitës në institucion, vlerëson se UET dhe çdo pedagog, siguron tekste mësimore cilësore dhe literaturë ndihmëse të mjaftueshme<br>GVJ sugjeron që kjo literaturë të përditësohet me botimet e fundit të fushave respektive referuar këtu programeve të lëndëve, të siguruara gjatë vizitës në institucion *(Dokumenti nr. 42: Menaxhimi i sektorit publik dhe administrata, Vizita në institucion)*<br>GVJ, konstaton nga informacioni, i marrë gjatë vizitës në institucion, se biblioteka e UET, ka literaturë që e ndihmon studentin për realizimin me |

| | |
|---|---|
| në mbështetje të programit të studimit, të projektit kërkimor shkencor dhe për përgatitjen e tezës nga studentët, përfshirë edhe buxhetin e planifikuar për këtë qëllim;<br>**Kriteri 5** Biblioteka ka orare të shërbimit në përshtatje me oraret e programeve të studimeve dhe nevojat e studentëve. | sukses të programit të studimit dhe për përgatitjen e tezës, por GVJ sugjeron shtimin e zërave të bibliotekës me literaturë cilësore të viteve të fundit, në përputhje me lëndët që programi MPMB përmban.<br><br>Në bibliotekën e UET, gjenden botime periodike dhe librari elektronike, të cilat përmbajnë libra apo revista shkencore të nevojshme, për realizimin me sukses të programit të studimit, të projektit kërkimor shkencor dhe për përgatitjen e tezës<br><br>Sipas GVB, përgjegjësit e programeve dhe pedagogët, janë të angazhuar për pajisjen e bibliotekës me tekstet mësimore dhe literaturës së fundit. GVJ konstatoi kërkesa të departamentit për blerje literature, shtimin e zërave të bibliotekës në mbështetje të programit të studimit, të projektit kërkimor shkencor dhe për përgatitjen e tezës nga studentët *(Dokumenti nr. 26 – 27: Kërkesa për blerje literature, Vizita në institucion)*<br><br>Referuar GVB, por edhe informacionit të siguruar nga studentët dhe nga personeli i bibliotekës gjatë vizitës në institucion, rezulton se orari i bibliotekës është përshtatur sipas programeve të studimit dhe është, e Hënë-Premte 9:00-20:00, e Shtunë 9:00-17:00. Gjatë sezonit të provimeve biblioteka funksionon me orar të zgjatur. |
| **Standardi V. 2- Institucioni vë në dispozicion të studentëve laboratorë të mjaftueshëm dhe mjedise të përshtatshme mësimore.** | |
| **Kriteri 1** Institucioni dëshmon se ka në sasi të mjaftueshme: laboratorë, klasa, zyra, studio e mjedise të tjera me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, për realizimin e programit të studimeve;<br>**Kriteri 2** Pajisjet e mjediseve mësimore janë të përshtatshme për mësimdhënie në përputhje me qëllimet e programit;<br>**Kriteri 3** Laboratorët përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme për plotësimin e kërkesave të programeve të studimeve dhe për zhvillimin e praktikave të parashikuara nga programi i studimit, në përputhje me qëllimet e programit, si dhe mirëmbahen dhe janë në përmirësim të vazhdueshëm;<br>**Kriteri 4** Institucioni, në varësi të programeve të studimeve që ofron, ka së paku një laborator, për secilin grup leksionesh ku parashikohen praktika laboratorike. | GVJ referuar Tabelës nr. 4.1 në shtojcën bashkëlidhur, vizitës në institucion dhe RVB, vlerëson se UET dëshmon se ka infrastrukturën e duhur në dispozicion të programeve të studimit<br><br>Klasat mësimore janë pajisur me pajisjet audio vizive të nevojshme për zhvillimin normal të proçesit mësimor. Ato janë të pajisura me videoprojektorë, sistem audio dhe me sistem kondicionimi. GVJ vlerëson se kjo infrastrukturë, është e përshtatshme për zhvillimin e procesit mësimor dhe të aktiviteteve të tjera mbështetëse për PS MPMB.<br><br>UET ka aktualisht në përdorim 4 laboratorë mësimorë informatike, përkatësisht Lab 205 B me 25 kompjutera dhe video projektor; Lab 206 B me 35 kompjutera dhe video projektor; Lab 207 B me 35 kompjutera dhe video projektor; Lab 208 B me 80 kompjutera<br><br>Programi i MPMB, me profile, nuk parashikon në kurrikulën e saj, zhvillimin e praktikave laboratorike. |

**Konkluzionet e vlerësimit:**

- GVJ mbështetur në dokumentacionin e dosjes së vetëvlerësimit, dokumentacionin e siguruar gjatë vizitës në institucion, vlerëson se UET siguron infrastukturën e nevojshme për realizimin e programeve të studimit MPMB, me profile.
- UET vendos në dispozicion të studentëve laboratorë të mjaftueshëm dhe mjedise të përshtatshme mësimore.

- GVJ sugjeron shtimin e zërave të bibliotekës me literaturë cilësore dhe të azhornuar të viteve të fundit, në përputhje me lëndët që PS MPMB me profile, përmban

GVJ bazuar në dokumentacionin e ofruar nga institucioni, vizitat në institucion dhe informacionin shtesë të siguruar gjatë këtyre vizitave, konkludon se **standardet e kësaj fushe janë plotësuar.**

**5. Financimi dhe menaxhimi i burimeve financiare**

**Pjesa përshkrimore**

**Terma reference**: burimet e financimit, kostoja për student, kapacitetet menaxhuese.

☑ Të ardhurat dhe financimet e ndryshme në këtë program studimi:

Referuar tabelës 8, në RVB, institucioni paraqet të ardhurat për vitet nga 2011-2016. Këto të ardhura, janë siguruar nga të ardhurat nga tarifat e shkollimit, grantet për kërkim si dhe nga aktivitetet tregëtare. Për vitin 2016, të ardhurat nga tarifat e shkollimit përbëjnë 85.5%, të ardhurat nga grantet për kërkime dhe kontratat përbëjnë 2.32%, dhe të ardhurat nga aktivitetet tregëtare 12.2%.

- Grantet për kërkim përbëjnë 2.32% të të ardhurave për vitin 2016, grantet për herë të parë janë përfshirë në 2013.
- Konsulencat, shërbimet, **nuk** kanë siguruar të ardhura gjatë 2012-2016.
- Tarifat për dhe gjatë shkollimit kanë siguruar 88.5 % të ardhurave gjatë 2017.
- Sponsorizimet **nuk** kanë siguruar të ardhura gjatë 2012-2016.
- Shërbimet trainuese **nuk** kanë siguruar të ardhura gjatë 2012-2016.
- Donacionet, aktivitetet siguruese etj **nuk** kanë siguruar të ardhura gjatë 2012-2016.
- Aktivitetet tregtare kanë siguruar 12.2 % të ardhurave gjatë 2016.

☑ Shpenzimet për studentët dhe kosto e studimit për student për vit akademik (në përqindje).

Të dhënat për kostot e studimit, paraqiten në Tabelën 5.2, në shtojcë.

**Vlerësimi sipas Standardeve**

| Standardi/Kriteret | Vlerësimi sipas standardeve |
|---|---|
| **Standardi II.9 - Institucioni bën një auditim të përvitshëm (të jashtëm dhe/ose të brendshëm) të situatës financiare.** | |

| | |
|---|---|
| **Kriteri 1** Raporti i auditit paraqet të gjithë situatën financiare për përdorimin e buxhetit të vënë në dispozicion për realizimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë;<br>**Kriteri 2** Raporti i auditit përmban një pasqyrë të qartë të granteve të huaja të përfituara dhe kontratave të shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë;<br>**Kriteri 3** Raporti i auditit analizon eficiencën e përdorimit të të ardhurave nga tarifat e studentëve në funksion të rritjes së cilësisë së studimeve në këtë cikël studimesh. | Referuar RVB, UET ka raport auditi çdo vit. Raportet përmbajnë transparencë në lidhje me kontabilizimin e të ardhurave dhe shpenzimeve, si dhe kategorizimin në llogaritë përkatëse, shfrytëzimin dhe eficensën e të ardhurave për funksionimin dhe rritjen e cilësisë së mësimdhënies, kërkimeve shkencore për studentët. Institucioni dokumenton raportet financiare për tri vitet e kaluara akademike.<br><br>Reflektimi i granteve në raportin e auditit, si dhe analiza financiare e përdorimit të të ardhurave nga tarifat e studentëve në funksion të rritjes së cilësisë së studimeve në këtë cikël studimesh, nuk mund të verifikohet pasi GVJ, nuk e gjeti një raport të auditimit të cituar në RVB, dhe as në takimet e realizuara në institucion. |
| **Standardi VI.1 - Institucioni harton një raport financiar të kostove të programeve të studimeve.** | |
| **Kriteri 1** Institucioni harton një raport që pasqyron të dhëna të hollësishme financiare të kostove për realizimin e programeve të studimeve, si kostot operacionale, kostot fikse të mjediseve dhe të pajisjeve, etj.<br>**Kriteri 2** Institucioni dëshmon se ka një qëndrueshmëri financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programeve të studimeve dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave në të ardhmen. | GVJ, konstaton se në RVB, paraqiten numri i studentëve për tre vitet e fundit dhe kostot/student në nivel institucioni dhe jo programi. Referuar RVB, për secilin vit akademik institucioni harton raportin, në lidhje me koston për secilin program studimi, për të kontrolluar ecurinë konform rregullave dhe standardeve. GVJ nuk konstatoi gjatë vizitës në institucion, një raport që pasqyron të dhëna të hollësishme financiare të kostove për realizimin e programeve të studimeve, si kostot operacionale, kostot fikse të mjediseve dhe të pajisjeve, etj.<br><br>GVJ konstaton prej informacionit të paraqitur në RVB, se ka ardhur në rënie numri i studentëve, kosto/student është rritur për 2016-2017, janë rritur të ardhurat nga grantet, janë rritur të ardhurat nga tarifat e shkollimit, si dhe është rritur kosto/student etj. Për të argumentuar qëndrueshmërinë financiare të institucionit duhet një informacion financiar i detajuar dhe i plotë. GVJ nuk konstatoi në RVB dhe nuk iu vendosën në dispozicion nga institucioni, dokument apo evidencë mbështetëse për këtë kriter, gjatë vizitës në institucion *(Dokumenti 62, Takimi GVB, vizita në institucion)*<br>Sugjerohet që GVB-të e ardhshme të depozitojnë raportet, si evidencë për të argumentuar konkluzionet e nxjerra për standardet financiare, si pjesë integrale e këtij vlerësimi të brendshëm. |

**Konkluzionet e vlerësimit:**

- UET paraqet kostot e programeve të studimeve në nivel institucioni dhe paraqet pasqyrën e të ardhurave dhe financimet gjatë 5 viteve të fundit.
- GVJ-së nuk iu vendosën në dispozicion nga institucioni, dokumente mbështetëse për standardet e kësaj fushe, në lidhje me raportet e auditimit për eficiencën e përdorimit të të

ardhurave nga tarifat e studentëve në funksion të rritjes së cilësisë së studimeve, për situatën financiare për përdorimin e buxhetit të vënë në dispozicion për realizimin e programeve të studimeve, si dhe informacion mbështetës për qëndrueshmërinë financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimeve dhe për kapacitetet financiare të mjaftueshme, për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave në të ardhmen.

- Sugjerohet që GVB-të e ardhshme të depozitojnë raportet, si evidencë për të argumentuar konkluzionet e nxjerra për standardet financiare, si pjesë integrale e këtij vlerësimi të brendshëm.

GVJ konkludon se **standardet e kësaj fushe plotësohen kryesisht.**

## 6. Sistemi i Brendshëm i Sigurimit të Cilësisë

**Pjesa përshkrimore**

**Terma reference**: institucionalizimi i sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë, ngritja e Njësisë së SBC, funksionimi i saj, vetëvlerësimi dhe përmirësimi i vazhdueshëm i cilësisë, rezultatet e vlerësimeve të jashtme.

Komisioni i Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (KSBC), e ka nisur punën që me krijimin e institucionit, fillimisht në formën e grupeve ad hoc, dhe që nga Janari 2011 në formën e një njësie të përhershme në strukturën organizative të institucionit. Komisioni vlerëson periodikisht efikasitetin e veprimtarive mësimore e kërkimore, administrative e financiare të UET-it. GVJ vlerëson përfshirjen e ekspertëve të jashtëm, në proçeset e vlerësimit të brendshëm, sepse rrit objektivitetin në gjykimet dhe rezultatet e vlerësimit.

☑ Të dhëna sasiore për punën konkrete në NJSBC për programin e studimit

Gjatë takimeve me KSBC, GVJ-së iu vendos në dispozicion informacion mbi mënyrën e funksionimit, rregulloren e saj, planin e veprimit, format e pyetsorëve të kryer etj. Aktivitetin e saj, *KSBC*-ja e zhvillon veprimtari të organizuar sipas një plani kalendarik të përvitshëm në të cilin programohen kontrollet apo proceset që i nënshtrohen kontrollit

KSBC në UET, fokuson aktivitetin e vetë edhe në një drejtim tjetër, që ka të bëjë me trajnimin e stafeve për përditësimin e metodave të mësimdhënies, për rregulloren e UET, etj.

GVJ konstaton, nga komunikimi me KSBC dhe me studentët e programit, se për vlerësimin e programit të studimeve, dhe të stafit të përfshirë në të KSBC, përdor metoda alternative, ku përvec pyetsorëve masivë on-line, organizohen dhe fokus grupe me studentët, për të siguruar informacion shtesë, informacion më cilësor, dhe për të shmangur asimetrinë e informacionit. Skedat e pyetësorëve përpunohen përmes programit të përdorur për vlerësimin online dhe i vendosen në dispozicion drejtuesve të institucionit, si edhe në mënyrë të personalizuar çdo pedagogu.

Duke filluar nga viti akademik 2016-2017, UET ka vënë në përdorim platformën LMS (Learning Management System) për menaxhimin e mësimdhënies online. Përvec qëllimeve të tjera, sistemi është edhe një mjet efiçent në dispozicion të KSBC-së, për të monitoruar mbarëvajtjen e proçesit të akademik, përmes të dhënave statistikore të gjeneruara nga ky sistem. Një formë alternative e kontrollit nga KSBC, është edhe ajo e kontrollit të provimeve të ndërmjetme dhe finale.

Nga takimi me titullarë të UET dhe kryetarin e KSBC, rezulton se UET ka aplikuar edhe një formë tjetër vlerësimi, atë prej vlerësimit nga ekspertë të jashtëm, për të identfikuar domosdoshmërinë e veprimeve rregulluese, në rast identifikimi të pikave të dobëta.

☑ Të dhëna për anëtarët e KSBC

Mbas njohjes me RVB si dhe takimit me KSBC, rezulton se KSBC ka në përbërje të saj 11 anëtarë, nga të cilët fakulteti i Ekonomisë dhe i Teknologjisë së Informacionit, ka dy përfaqësues. *(Tabela 6, shtojca)*

☑ Përgjegjësitë në monitorimin dhe menaxhimin e cilësisë deri në nivel departamenti

Aktualisht përfaqësimi në KSBC është në nivel fakulteti. Për të përcjellë dinamikën e ndryshme të problemeve, në programe të ndryshme të studimit, sugjerohet që KSBC të ketë përfaqësues nga çdo departament.

☑ Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion

Gjate vizitës në institucion, GVJ-se në lidhje me sigurimin e brendshëm të cilësisë, GVJ iu vendosën në dispozicion dokumentat e kërkuar, të cilët u shqyrtuan në funksion të konkluzioneve të nxjerra për këtë rubrikë *(Dokumenti nr. 15: "Formatet e vlerësimit të pedagogut", dosja e vetëvlerësimit, Dokumenti nr. 30: KSBC_Raporte; Dokumenti nr. 6 "Plani i veprimit KSBC, viti akademik 2016-2017"; Dokumenti nr. 51: Pyetjet per Fokus Grup 17-18, Vizita në institucion)*

**Vlerësimi sipas Standardeve**

| Standardi/Kriteret | Vlerësimi sipas standardeve |
|---|---|
| **Standardi I.10 - Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë e programeve të studimeve.** | |
| **Kriteri 1** Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë e programeve të studimeve;<br>**Kriteri 2** Institucioni e përfshin këtë informacion në vetëvlerësimin që bën për arritjen e sigurimit të brendshëm të cilësisë;<br>**Kriteri 3** Institucioni publikon rezultatet e vlerësimit dhe rezultatet që synon të arrijë;<br>**Kriteri 4** Institucioni, për kryerjen e vlerësimit, përdor metoda të tërthorta ose të drejtpërdrejta.<br><br>Të tërthorta:<br>a. Sondazhe: të studentëve që ndjekin programet e studimeve, të të diplomuarve në këto programe në vitet e mëparshme akademike apo në ciklet e ndryshme të studimeve;<br>b. Sondazhe të vlerësimit të mësimdhënies, kurrikulës, të të mësuarit;<br>c. Pyetje konceptuale;<br>d. Intervista;<br>e. Etj.<br><br>Të drejtpërdrejta:<br>a. Rezultatet e arritura nga studentët në teste të standardizuara kombëtare/ndërkombëtare (p.sh. provimi i shtetit për profesionet e rregulluara, etj);<br>b. Dëgjime në auditor;<br>c. Rezultatet e arritura nga studentët në provimet e vlerësuara me nota/pikë;<br>d. Rezultatet e arritura nga studentët në testimet paraprake dhe përfundimtare, provimet për module, praktikat profesionale; | GVJ konstaton se UET është duke përdorur një tërësi instrumentash, për sigurimin e cilësisë në kuadrin e një metodologjie.<br><br>Sipas informacionit të siguruar gjatë vizitës në institucion me drejtues të KSBC, raporti i vlerësimit, ju shkon drejtuesve të institucionit, të cilët e përfshijnë atë në vetëvlerësimin institucional. *(Dokumenti nr. 30: KSBC_Raporte, Vizita në institucion)*<br><br>GVJ nuk gjeti informacion rreth publikimit të rezultateve të vlerësimit apo të rezultateve që synon të arrijë. GVJ sygjeron, që UET të publikojë rezultatet e përgjithshme të vlerësimit dhe të dokumentohet publikimi i tij.<br><br>GVJ konstaton, nga komunikimi me drejtues të KSBC dhe me studentët e programit, se për vlerësimin e programit të studimeve, dhe të stafit të përfshirë në të, KSBC përdor metoda alternative, ku përvec pyetësorëve masivë on-line, organizohen dhe fokus grupe me studentë, për të siguruar informacion shtesë, informacion më cilësor, dhe për të shmangur asimetrinë e informacionit. *(Dokumenti nr. 15: "Formatet e vlerësimit të pedagogut", dosja e vetëvlerësimit, Dokumenti nr. 51: Pyetjet per Fokus Grup 17-18, Vizita në institucion)*<br><br>Një formë alternative e kontrollit nga KSBC, është edhe ajo e kontrollit të provimeve të ndërmjetme dhe finale. |

| | |
|---|---|
| e. Rezultatet e arritura nga studentët në vlerësimin e detyrave të kryera gjatë zhvillimit të programit të studimit (punë individuale apo në grup, detyra kursi për të analizuar të kuptuarit konceptual, referatet, projektet, provimet, etj.);<br>f. Vëzhgime gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës;<br>g. Rezultatet e arritura dhe cilësia e rezultatit të kërkimit - tezës;<br>h. Etj. | Nga takimi me titullarë të UET dhe kryetarin e KSBC, rezulton se UET ka aplikuar edhe një formë tjetër vlerësimi, atë prej vlerësimit nga ekspertë të jashtëm, për të identifikuar domosdoshmërinë e veprimeve rregulluese në rast identifikimi prej tyre të pikave të dobëta. (*Dokumenti nr. 58: Vendim_Angazhimi eksperteve te jashtëm, Vizita në institucion*). Gjithashtu aplikohen nga drejtues të njësisë bazë, dëgjime në auditor sidomos për stafin e ri të rekrutuar. |
| **Standardi I.13 - Institucioni publikon rregullisht informacion të paanshëm dhe objektiv, sasior e cilësor, për vlerësimin e brendshëm.** | |
| **Kriteri 1** Institucioni publikon rregullisht broshura, buletine etj., të hartuara dhe botuara nga institucioni, për vlerësimin e brendshëm;<br>**Kriteri 2** Institucioni publikon rregullisht prezantime në faqe interneti, video e audio etj. për vlerësimin e brendshëm. | Referuar RVB, UET përgatit dhe shpërndan në formën e një raporti vlerësimet periodike mbi cilësinë, i cili u vihet në dispozicion strukturave drejtuese por edhe pedagogëve, sikurse dhe aktorëve të tjerë të interesuar.<br><br>Këto raporte janë pjesë e diskutimit dhe prezantimit në nivel rektorati, sikurse dhe në nivel departamenti. GVJ nuk gjeti praktika të publikimit të broshurave, buletineve etj., për vlerësimin e brendshëm<br><br>GVJ sugjeron që institucioni të publikojë rregullisht broshura, buletine, prezantime në faqe internet, video e audio, mbi vlerësimin e brendshëm |
| **Standardi II.7 - Institucioni kryen një analizë vjetore për vlerësimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë.** | |
| **Kriteri 1** Institucioni harton një analizë vjetore për vlerësimin e ecurisë së programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë;<br>**Kriteri 2** Institucioni harton politika që synojnë përmirësimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë. | Referuar RVB, takimeve me KSBC dhe drejtues rezulton se UET analizon mbi bazë fakulteti dhe departamenti, ecurinë e programeve të studimeve, duke përfshirë në to mendimin e përfaqësuesve të tregut të punës dhe opinionin e studentëve.<br><br>Bazuar në feedback-un e marrë nga studentët, nëpërmjet pyetësorëve dhe fokus grupeve por dhe aktorëve të tjerë, UET programon politika dhe ndërmerr masa për zhvillimin e mëtejshëm të programeve të studimit |
| **Standardi VIII.1 - Institucioni garanton sigurimin e cilësisë në realizimin e programeve të studimeve.** | |

| | |
|---|---|
| **Kriteri 1** Institucioni ka plotësuar standardet institucionale dhe është akredituar në nivel institucional përpara aplikimit për akreditimin e programeve të studimeve;<br>**Kriteri 2** Institucioni përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë;<br>**Kriteri 3** Institucioni harton një politikë dhe ndjek procedura të caktuara për sigurimin e cilësisë dhe standardeve të programeve të tyre;<br>**Kriteri 4** Institucioni përdor mekanizma formalë për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të studimit;<br>**Kriteri 5** Institucioni synon ndërgjegjësimin e personelit të vet dhe të studentëve që ndjekin programet e studimeve që ofrohen, për rëndësinë e cilësisë dhe sigurimin e cilësisë në to;<br>**Kriteri 6** Institucioni harton dhe zbaton një strategji për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë. Strategjia, politika dhe procedurat janë publikuar. | Për GVJ rezulton se UET ka plotësuar standardet institucionale dhe është akredituar në nivel institucional, përpara aplikimit për riakreditimin e programit të studimeve MPMB, me profile.<br><br>Referuar RVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitës në institucion, rezulton se UET përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë<br><br>Për të siguruar cilësinë e proçeseve akademike UET harton politikat përkatëse përmes shqyrtimit dhe miratimit të tyre në Senatin Akademik dhe strukturat e tjera në nivel njësie kryesore dhe njësie bazë, në zbatim të Statutit dhe Rregullores së UET për cilësinë.<br><br>GVJ konstaton se UET përdor mekanizma formalë për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të studimeve që ofron, si pyetësore, fokus grupe, kontroll të provimeve, kontrolle në auditor nga drejtues të njësisë bazë si dhe ekspertë të jashtëm<br><br>Ndërgjegjësimi i personelit në UET, synohet përmes një larmie formash, nga trajnimi deri te rifreskimi i njohurive mbi standardet dhe kërkesat e veçanta për cilësi. Po ashtu, studentët njihen me kërkesat mbi cilësinë në UET me fillimin e vitit akademik dhe gjatë vitit në takime të veçanta me drejtuesit e institucionit, pedagogët, etj.<br><br>Strategjia mbi sigurimin e vazhdueshëm të cilësisë zbatohet përmes veprimtarisë së strukturave drejtuese dhe aktivitetit të KSBC (*Dokumenti nr. 6 "Plani i veprimit KSBC, viti akademik 2016-2017", Vizita në institucion)*<br><br>GVJ sugjeron publikimin e strategjisë dhe politikave për përmirësimin e cilësisë nëpërmjet broshurave, buletineve apo prezantimeve video, në faqen e internetit të UET. |

**Konkluzionet e vlerësimit:**

- UET përdor një metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë e programeve të studimeve.
- UET kryen një analizë vjetore për vlerësimin e programeve të studimeve te studimit.
- UET garanton sigurimin e cilësisë në realizimin e programeve të studimeve.
- GVJ sugjeron që institucioni të publikojë rregullisht broshura, buletine, prezantime në faqe internet, video e audio, mbi vlerësimin e brendshëm.

GVJ bazuar në dokumentacionin e ofruar nga institucioni, vizitat në institucion dhe informacionin shtesë të siguruar gjatë këtyre vizitave, konkludon se **standardet e kësaj fushe plotësohen**

## POLITIKAT E FORMIMIT TË STUDENTËVE

## 7. Programi i studimit, organizimi i tij

### Pjesa përshkrimore

> **Terma reference**: misioni dhe objektivi i programit të studimit, përmbajtja e programit, organizimi i vitit mësimor, semestrat, plani mësimor me të gjithë elementët e tij (lëndët/modulet, kreditet përkatëse, ndarja e orëve për çdo kredit në varësi të formave të studimit, orët mësimore përkatësisht në auditor/jashtë auditorit të ndara sipas formave të mësimdhënies), literatura dhe materiale të tjera mbështetëse e ndihmëse, etj

Programi i studimit Master Profesional në "Menaxhim Biznesi", me profile; "Menaxhim SME-ve", "Menaxhim i Burimeve Njerëzre dhe Karrierës", "Institucioneve dhe Administrim Publik", ofrohet nga Departamenti i Menaxhimit dhe Marketingut. Ky program studimesh ka filluar si MNP me Vendim Nr. 74, dt. 21.01.2009 të Këshillit të Ministrave, në përputhje me Ligjin e Arsimit të Lartë Nr. 9741, datë 21.05.2007, i ndryshuar. Sipas këtij vendimi të KM, UET do të ofrojë programe të studimeve në MNP me së paku 60 ECTS dhe kohëzgjatje normale 1 vit akademik. Më pas institucioni ka bërë riorganizmin e këtij programi si program i ciklit të dytë Master Profesional duke e ofruar me kohëzgjatje 1/1.5 vite akademike dhe 60/90 ECTS. Sipas Ligjit të Arsimit të Lartë por edhe udhëzimet përkatëse për rirorganizimin e programeve të studimit shprehet qartë që riorganizimi i një programi studimesh me më shumë se 20 %, të kurrikulës së tij bëhet me urdhër të ministrit përgjegjës të arsimit. Nuk disponohet një urdhër i tillë dhe nuk ka një praktikë të nisur nga institucioni dhe të ndjekur nga ministria për këtë çështje. Sipas dokumetacioni të ASCAL, kjo situatë i është bërë e ditur ministrisë së arsimit dhe sportit me shkresë nr. 202/1, datë 26.07.2017, dhe për dijeni gjithashtu edhe vetë institucionit. Gjithashtu është ridërguar me shkresë nr. 202/3 prot., datë 30.10.2017. Kjo kërkesë ka marrë përgjigje nga MASR me shkresë drejtuar UET nr. 8571/1, ku sqarohet që ky program studimesh është përshtatur konform ligjit të arsimit të lartë të vitit 2007.

Në vazhdimësi, dhe në përputhje me parashikimet e ligjit të ri për arsimin e lartë Ligji Nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", (neni 75, pika 6) Senati Akademik i Universitetit Europian të Tiranës ka miratuar përshtatjen e kohëzgjatjes normale të programeve të ciklit të dytë, Master profesional, që ofrohen nga UET. Në bazë të Vendimit Nr. 7, datë 14.09.2016, pika 1, Senati Akademik i UET ka vendosur që programet Master Profesional të ofrohen me 60 ECTS, me kohëzgjatje normale 1 (një) vit akademik, vendim që ka hyrë në fuqi për vitin akademik 2016-2017.

Ky program studimesh është ndërtuar duke patur si qëllim nevojat e tregut të punës për specialistë të aftë në drejtim të menaxhimit të organizatave private dhe publike.

Pasi i konsultua më rregulloren e Programit dhe bisedat me stafin, studentët dhe drejtuesit e institucionit, GVJ konstaton se në përfundim të këtij programi studimi, studenti do të jenë i aftë të:

- Të kenë një formim profesional të përqëndruar në njohuritë dhe kompetencat kyçe të domosdoshme për t'i përdorur në karrierën e ardhshme.
- Të pajisen me njohuri teorike dhe praktike mbi mënyrat dhe metodat e menaxhimit të funksioneve apo veprimtarive të ndryshme të biznesit.

Për t'u pranuar në programin e studimit të ciklit të dytë, Master Profesional, studenti duhet të zotërojë së paku një diplomë të nivelit të parë (Bachelor) ose një diplomë tjetër të fituar jashtë vendit, të vlerësuar ekuivalente me të. Diploma e fituar nga studimet në ciklin e parë mund të jetë në të njëjtën fushë studimi ose në fusha të tjera të ngjashme me formimin që ofron ky program, por edhe në fusha të ndryshme. Studentët regjistrohen në këtë program studimi, pa plotësime të njohurive formuese (pa debi formimi). Afati normal i studimeve për programet e ciklit të dytë të

studimeve, Master Profesional është 1 vit. Pas mbarimit të afatit të përcaktuar marrëdhënia mes Universitetit dhe Studentit rinegociohet.

Aktualisht, numri i lëndëve që përbëjnë këtë program studimi është 6 (gjashtë) dhe ndahen në 1 lëndë të formimit të përgjithshëm (A), 3 lëndë të formimit karakterizues të programit (B), 2 lëndë në disiplina të ngjashme (bazuar në profilin e zgjedhur nga studenti), (*Tabela 7.2 në Anekse*). Secila nga lëndët e ndjekura ka 6 ECTS. Më pas studentët ndjekin praktikën profesionale dhe mbrojnë punimin e diplomës. Planet mësimore janë nën vëzhgim të vazhdueshëm dhe kanë qënë subjekt i ndryshimeve që janë pasqyruar në Tabelën 7.3 në Anekse.

**<u>Vlerësimi i Treguesve të matshëm:</u>**

☑ Viti i fillimit, qëllimet dhe objektivat e çdo programi studimi

Programi i studimit "Master Profesional" në "Menaxhim Biznesi", ka filluar si MNP me Vendim Nr. 74, dt. 21.01.2009 të KM, në përputhje të Ligjit të Arsimit të Lartë Nr. 9741, datë 21.05.2007, i ndryshuar. Më pas ai është riformatuar në Master Profesional. Sic është thekësuar edhe më sipër, përpara vitit 2016 ky program studimesh ofrohej me 60 dhe 90 ECTS, ndërkohë spas ristrukturimeve në përputhje me dispozitat e reja në fuqi, nga viti 2016 ofrohet në një vit akademik me 60 ECTS.

☑ Organizimi i programit të studimit (vite, semestra, javë etj.)

- 1 vit akademik ka 28 javë mësimore në auditor
- 1 Semestër ka 14 javë mësimore në auditor
- Aktualisht, ky program studimi në Menaxhim Biznesi është i organizuar në 1 vit mësimor (2 semestra). Semestri i parë i është dedikuar moduleve të ndryshme ndërsa në semestrin e dytë studentët ndahen sipas profileve dhe zhvillojnë module sipas kësaj ndarje, ndërkohë që zhvillojnë praktikën mësimore dhe punimin e temës së diplomës.

☑ Plani mësimor sipas viteve akademike, ndarja e ECTS sipas formave të mësimdhënies për çdo lëndë

Plani mësimor për programin Master Profesional në Menaxhim Biznesi jepet ne Anekse, Tabela 7.1.

☑ Mënyra e përcaktimit të krediteve (ECTS) për format e studimit:

| | | |
|---|---|---|
| ▪ Për leksionet | 11 orë në auditor dhe | 14 orë punë e pavarur e studentit |
| ▪ Për Seminaret | 7 orë në auditor dhe | 18 orë punë e pavarur e studentit |
| ▪ Për Laboratoret | NA orë në auditor dhe | NA orë punë e pavarur e studentit |
| ▪ Për Praktikat lëndore | NA orë në auditor dhe | NA orë punë e pavarur e studentit |
| ▪ Për Praktikën Profesionale | 22 orë në auditor dhe | 3 orë punë e pavarur e studentit |
| ▪ Provimi përfundimtar/Diploma | 1.5 orë në auditor dhe | 23.5 orë punë e pavarur e studentit |

☑ Ndryshimet në Planet mësimore, krahasuar me programet mësimore të licensuara

Ndyshimet që kane ndodhur në planet mësimore të UET për këtë program studimi janë pasyruar në Tabele 7.1 (ku jepet situata me 60 dhe 90 ECTS) dhe Tabelën 7.3 në Anekse.

☑ Planet mësimore të lidhura me personelin akademik përkatës

Planet mësimore të lidhura me personelin akademik përkatës të UET janë pasyruar, për gjashtë vitet e fundit akademike në Tabelën 8.1 në Anekse.

☑ Analizë e cilësisë së syllabuseve

GVJ, vlerëson se përbërja e sylabuseve të paraqitura si dokument mbështetës nga IAL, është në përputhje me standartet dhe kriteret e zhvillimit të cikleve të studimeve të nivelit të dytë. Tabela përmbledhëse që pasqyrojnë ecurinë në vite të moduleve, padagogut që zhvillon modulin, semestrin dhe vitin kur zhvillohet moduli, etj. janë të dhëna në Anekse, Tabelat 7.1, 7.2, 8.1.

Megjithatë nga një vrojtim i hollësishëm i syllabuseve dhe një krahasim i përmbajtjes së tyre me ato që zhvillohen në programe studimesh të tjera nga ky institucion dhe më specifikisht në Master Shkencor në "Administrim Biznesi", me profile, GVJ vuri re një ngjashmëri shumë të lartë. Nga një krahasim midis moduleve që zhvillohen në Programin e studimeve Master Profesional në "Menaxhim Biznesi" u vu re se të katërta modulet që ofrohen të përbashkëta për të tre profilet janë të njëjta me ato që ofrohen në Master Shkencor. Ndërkohë edhe të dy modulet që ofrohen në profilin "Institucioneve dhe Administrim Publik" janë po njësoj me ato që ofrohen në Master Shkencor. Në total ngjashmëria është në masën 60%.
Ajo çka sygjerohet nga GVJ është një diferencim midis moduleve që zhvillohen në programe "Master Profesional" nga ato që zhvillohen në "Master Shkencor". Kjo për vetë natyrën e ndryshme dhe fokusin qëndror që kanë këto programe studimesh.

**Vlerësimi sipas Standardeve**

| Standardi/Kriteret | Vlerësimi sipas standardeve |
|---|---|
| **Standardi I.1 - Institucioni ofron programe studimesh në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij.** | |
| **Kriteri 1** Institucioni ofron programe të akredituara të studimeve, të organizuara në module dhe të vlerësuara në kredite, sipas Sistemit Europian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS);<br>**Kriteri 2** Sasia mesatare e krediteve të grumbulluara gjatë një viti nga një student që ndjek një program studimi me kohë të plotë është 60 kredite; | Programi i studimit "Master Profesional" në "Menaxhim Biznesi", me profile; "Menaxhim SME-ve", "Menaxhim i Burimeve Njerëzore dhe Karrierës", "Institucioneve dhe Administrim Publik", ofrohet nga Departamenti i Menaxhimit dhe Marketingut. Ky program studimesh ka filluar si MNP me Vendim Nr. 74, dt. 21.01.2009 të KM, në përputhje të Ligjit të Arsimit të Lartë Nr. 9741, datë 21.05.2007, i ndryshuar. Sipas këtij vendimi UET do të ofrojë programe të studimeve në MNP me së paku 60 ECTS dhe kohëzgjatje 1 vit.<br>Programi i studimeve është një program i akredituar për herë të parë në vitin 2011, Urdhër Nr. 68, dt.14/02/2011 i Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, bazuar në Vendimin Nr. 133, datë 21.12.2010 të Këshillit të Akreditimit. Gjithashtu me Urdhër Nr. 380, dt. 12.10.2015, është bërë riregjistrimi i formave të diplomave për "Bachelor", "Master Profesional" dhe "Master Shkencor", sërisht nga Ministria e Arsimit.<br>Organizimi i këtij programi studimesh që nga viti akademik 2016-2017 (sipas programit të studimeve) bazohet në 2 semestra mësimore ku në Semestrin I zhvillohen 4 modulet përkatëse dhe në semestrin e dytë bëhet ndarja sipas profileve, zhvillohen 2 module të tjera dhe realizohet praktika mësimore dhe mbrojtja e diplomës.<br>Numri i krediteve për çdo modul të këtij programi është 6 ECTS, praktika mësimore vlerësohet me 10 ECTS dhe diploma 14 ECTS. Studentet pajisen me 60 ECTS për 1 vit mësimor për të gjithë ciklin e studimeve, në përputhje kjo me kërkesat ligjore në fuqi. |
| **Standardi I.2 - Programet e studimeve janë në përputhje me strategjinë për zhvillim të institucionit.** | |

| | |
|---|---|
| **Kriteri 2** Programet e studimeve të ciklit të dytë "Master i Shkencave", "Master i arteve të bukura" apo "Master Profesional" i pajisin studentët që zotërojnë diplomën universitare "Bachelor" me njohuri të thelluara, teorike dhe praktike, si dhe trajnim për kërkim shkencor apo trajnim të mirëfilltë profesional;<br>**Kriteri 3** Programet e studimeve "Master i Shkencave" ose "Master i arteve të bukura" dhe "Master Profesional" synojnë të zgjerojnë njohuritë e fituara në ciklin e parë të studimeve;<br>**Kriteri 4** Programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë (në mjekësi, stomatologji, farmaci, veterinari, arkitekturë) i pajisin studentët me njohuri të thelluara dhe kompetenca shkencore, teorike dhe praktike, si dhe trajnim për kërkim shkencor sipas fushës. Pas përfundimit të tyre si dhe përfundimit me sukses të provimit të shtetit për programin specifik, studentët fitojnë të drejtën e ushtrimit të një profesioni të rregulluar sipas ligjit në fuqi;<br>**Kriteri 5** Programet e studimeve të këtij cikli i pajisin studentët me kompetenca të përgjithshme dhe profesionale që synohen të arrihen apo të zgjerohen gjatë zhvillimit të tij;<br>**Kriteri 6** Programet e studimeve "Master i Shkencave" ose "Master i arteve të bukura"dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë krijojnë baza të qëndrueshme njohurish për studimet e ciklit të tretë doktoratës, duke përfshirë aftësimin për kërkimin shkencor dhe plotësimin e parakushteve (njohuri, aftësi dhe kompetenca) për pranimin në ciklin e tretë të studimeve;<br>**Kriteri 7** Programet e studimeve "Master Profesional" kanë objektiva të qartë profesionalë, të justifikueshëm, të arritshëm, me synime të qarta për arritjen e kualifikimit të nevojshëm dhe në përputhje me kërkesat e tregut të punës. | Programi i sudimeve "Master Profesional" në "Menaxhim Biznesi", me profile; "Menaxhim SME-ve", "Menaxhim i Burimeve Njerëzore dhe Karrierës", "Institucioneve dhe Administrim Publik", pranon studentë që kanë përfunduar studimet e tyre Bachelor brënda këtij institucioni apo IAL të tjera ngjashme.<br>Kurrikula e programit të studimeve është e ngritur në mbështetje të Misionit të IAL dhe synon të pajisë studentët me njohuri bazë teorike dhe praktike lidhur me dipomën që ata marin. Kjo mbështet dhe nga programi i studimeve si dhe nga praktika mësimore që studentët duhet të ndjekin në semestrin e dytë të studimeve. Mbështetur në takimet e zhvilluara në IAL, GVJ konstaton se institucioni zhvillon konsulta me bizneset me qëllim përmirësimin e kurrikulës së studimeve. (*Dokument nr. 16: Bordi i tregut të punës, Vizita në institucion*)<br>GVJ konstaton se ky program studimi i ciklit të dytë i pajis studentët me kompetenca të përgjithshme dhe profesionale, që vijnë të përshkallëzuar nga një përsëritje e njohurive bazë të marra në ciklin e parë të studimeve. Për t'u thelluar më pas gjatë studimeve MP dhe për të konkluduar me praktikën mësimore dhe mbrojtjen finale të temës. |
| **Standardi I.4 - Programet e studimeve ofrohen në përshtatje me nivelin e studimeve.** | |
| **Kriteri 1** Përmbajtja dhe renditja e objektivave të programeve të studimeve synojnë arritjen e qëllimeve të tyre në përputhje me nivelin e studimeve në të cilin ofrohen ato;<br>**Kriteri 2** Metodat e vlerësimit të studentëve nëpërmjet kontrollit të vazhdueshëm të njohurive me anë të testeve me përgjigje alternative apo provimeve përfundimtare dëshmojnë ecurinë dhe arritjet e studentëve për ciklin përkatës të studimeve. | GVJ konstaton se programi i studimeve "Master Profesional" në "Menaxhim Biznesi", me profile, është i ndërtuar dhe vjen në formë të përshkallëzuar lidhur me njohuritë që studentet marrin në vazhdimësi të studimeve të tyre pas përfundimit të ciklit Bachelor.<br>Vlerësimi i studentëve është i vazhduar, fillon gjatë vitit akademik me vlerësime periodike në formë testesh të ndërmjetme, detyrash kursi, vlerësime gjatë proçesin mësimor, dhe përfundon me provimin final të modulit përkatës. Përkatësisht studenti mer 10% të vlerësimit gjatë pjesëmarjes aktive në seminare, 20% gjatë detyrave të kursit, 30% në provimin e ndërmjetëm dhe 40% në provimin final të |

| | |
|---|---|
| | modulit. (*Vizita në Institucion: Takimi me studentët, Tabela 8.3 në Anekse*) |
| **Standardi I.5 - Programet e studimeve synojnë të arrijnë dimensione ndërkombëtare.** | |
| **Kriteri 1** Programet e studimeve mbështeten në përvojën disavjeçare dhe praktikat e mira të vendeve europiane;<br>**Kriteri 2** Programet e studimeve janë ndërkombëtarisht konkurruese për nga elementet që përmbajnë (të dhëna të përgjithshme, objektivat kryesorë, plani mësimor, kreditet, kushtet e pranimit në tometodat e vlerësimit, kriteret dhe procedurat e tranferimit të krediteve e njohurive të fituaara, diplomat që jepen në përfundim etj.) duke afirmuar vlerat e arsimit universitar në Shqipëri;<br>**Kriteri 3** Programet e studimeve janë hartuar në përputhje me objektivat e përcaktuar në legjislacionin dhe direktivat e BE-së për arsimin e lartë dhe profesionet e rregulluara. | Që në konceptimet e tij fillestare ky program studimi është hartuar duke iu referuar përvojave më të mira bashkëkohore europiane dhe të vendit, sidomos është bazuar në formimin anglo sakson. Programi "Master Profesional" në "Menaxhim Biznesi", me profile, është hartuar bazuar në kriteret dhe procedurat në fuqi në lidhje me programet e studimit "Master Profesional" si edhe duke vlerësuar nevojat e tregut të punës. Sipas vlerësimit të GVB dhe raportit të marë prej tij, në hartimin e tij janë marrë në konsideratë elementë të programeve të ngjashme të institucioneve të arsimit të lartë në vendet europiane dhe në botë. |
| **Standardi I.6 - Programet e studimeve përfshijnë aftësimin profesional dhe kërkimin shkencor.** | |
| **Kriteri 1** Programet e studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë përfshijnë aftësimin profesional dhe kërkimin shkencor;<br>**Kriteri 2** Programet e studimeve hartohen në përputhje me profilin e Institucionit të Arsimit të Lartë dhe strategjinë e tij për zhvillim;<br>**Kriteri 3** Personeli akademik angazhohet në punën kërkimore shkencore për realizmin e programeve të studimeve;<br>**Kriteri 4** Puna kërkimore e personelit akademik të angazhuar për realizimin e programit të studimeve përkon me synimet për arritjen e qëllimeve të tij. | Aftësimi profesional i studentëve është një nga shtyllat kryesore të konceptimit të këtij programi studimi. Kjo gjë realizohet duke filluar nga trajtime teorike të problemeve në module të ndryshme dhe konkludohet me praktikën mësimore në semestrin e 2. Gjatë muduleve që ndjekin, studentëve u ofrohen lëndë me karakter aplikativ që i ndihmojë ata më pas në praktikën profesionale. Më pas studentët shkojnë me praktikën mësimore direkt në vendet që ata kanë zgjedhur apo u janë dhënë nga institucioni. Sipas diskutimeve në UET gjatë vizitës, u konstatua se studentët e këtij cilki studimesh, në pjesën më të gjërë të tyre janë të punësuar përpara se të fillojnë studimet. Në këtë mënyrë ata e zhvillojnë praktikën mësimorë pranë vendeve ku ata punojnë.<br>Gjithashtu gjatë intervistës me studentët, u konstatua se ata angazhohen në procese të ndryshme intervistimi në funksion të projekteve kërkimore të stafit akademik.<br>Puna kërkimore e stafit akademik është në përpudhje me misionin e institucionit, për tu kthyer në një qëndër e promovimit të inovacionit dhe shkencës. Puna kërkimore e personelit akademik të përfshirë në këtë program është në përputhje me këtë program studimi dhe qëllimet e tij. |
| **Standardi I.7 - Programet e studimeve "Master Profesional" ofrohen në përputhje me nevojat e tregut të punës.** | |
| **Kriteri 1** Programet e studimeve të ciklit të dytë "Master Profesional" ofrohen në përputhje me nevojat e tregut të punës;<br>**Kriteri 2** Programet e studimeve të ciklit të dytë "Master Profesional" synojnë të plotësojnë | Universiteti Europian i Tiranës, që në fillimet e organizimit të ciklit të dytë të studimeve është bazuar në nevojat e tregut. Edhe sot pas shumë vitesh aktivitet ky institucin realizon studime tregu lidhur me mundësitë e punësimit që kanë studentët e tij. |

| | |
|---|---|
| nevojat në sektorët përkatës të ekonomisë vendase apo të huaj. | Ndërkohë 2 herë në vit, bazuar në një kalendar të përcaktuar, mbledhjet e departamentit bëhen me përfaqësues të Bordit të Tregut të Punës të cilët ofrojnë njohuritë dhe sugjerimet e tyre në lidhje me zhvillimet në mjedisin e jashtëm. (*Dokument nr. 16: Borti i tregut të punës; Dokument nr. 1: Studimi Alumni, Vizita në institucion*)<br>Bazuar në rekomandimet që vijnë nga Bordi i Tregut të Punës ndodhin ndryshime që pasqyrohen vazhdimisht në programet e lëndëve dhe në gamën e lëndëve me zgjedhje që ofrohen. (*Tabela 7.3 në Anekse*) |
| **Standardi I.8 - Programet e studimeve marrin parasysh nevojat e tregut të punës.** | |
| **Kriteri 1** Programet e studimeve marrin parasysh nevojat e tregut të punës, dhe hartohen në përputhje me synimet strategjike të zhvillimit ekonomik kombëtar;<br>**Kriteri 2** Institucioni, për vlerësimin e nevojave të tregut të punës, kryen një studim tregu, i cili përfshin:<br>a. mundësitë e punësimit të studentëve në tregun vendas ose atë rajonal, kombëtar a ndërkombëtar;<br>b. kërkesat e punëdhënësve;<br>c. një parashikim të përafërt për numrin e pritshëm të studentëve që mund të regjistrohen në këtë program;<br>d. numrin e të regjistruarve në programe të ngjashme në institucionet simotra. | Siç u theksua edhe më sipër, UET ka zhvilluar dhe zhvillon studime tregu lidhur me nevojat për programet e ndryshme të studimeve si dhe për ndryshime të mundëshme në kurrikulat e tyre.<br>Bazuar në RVB, edhe Programi 250+ si vazhdim i inisiativës dhe strategjisë së UET për t'u shndërruar në Universitet i Biznesit, synon që nëpërmjet bashkëpunimit me bizneset të kuptojë kërkesat e tyre në lidhje me programet e ciklit të dytë në mënyrë që t'i reflektojë më tej në kurrikula dhe syllabuse. Programi synon bashkëpunimin me këto kompani për të integruar studentët në internshipe dhe deri në punësimin e tyre. |
| **Standardi I.9 - Programet e studimeve synojnë ruajtjen e vlerave kulturore kombëtare dhe interesave kombëtare.** | |
| **Kriteri 1** Institucioni ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interest kombëtare;<br>**Kriteri 2** Programet e studimeve synojnë të ndihmojnë ruajtjen e vlerave kulturore kombëtare. | Programi i studimeve "Master Profesional" në "Menaxhim Biznesi", me profile, nuk bie ndesh me interesat kombëtare dhe tenton ruajtjen e vlerave kulturore. |
| **Standardi I.12 - Kohëzgjatja dhe numri i krediteve për programet e studimeve të këtij cikli janë në përputhje me me ligjin nr. 9741, datë 21.5.2007, "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.** | |
| **Kriteri 1** Programet e studimeve "Master i Shkencave" realizohet me 120 kredite europiane ECTS, ku përfshihen 30-40 kredite europiane ECTS për projektin kërkimor dhe tezën që duhet përgatitur në përfundim të këtyre programeve të studimeve. Kohëzgjatja normale e tyre është 2 vite akademike; | **NA** |
| **Kriteri 2** Programet e studimeve "Master Profesional" realizohen me 60-90 kredite europiane ECTS. Kohëzgjatja normale e tyre është 1-1.5 (një deri në një vit e gjysmë) vite akademike. | Aktualisht programi i studimeve Master Profesional në "Menaxhim Biznesi", me profile, zhvillohet në 1 vit akademik dhe përmban 60 ECTS. Punimi i diplomës vlerësohet me 14 ECTS.<br>Nga viti 2010-2016 ky program studimesh është ofruar në 1 vit (60 ECTS) dhe 1.5 vite (90 ECTS). Sipas ndryshimeve të kryera në përshtatje me ligjin e |

| | |
|---|---|
| | ri të Arsimit të Lartë, nga viti 2016 ofrohet vetem në 1 vit (60 ECTS). |
| **Kriteri 3** Programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë përfundojnë me marrjen e diplomës "Master i Shkencave". Ato realizohen me jo më pak se 300 kredite europiane ECTS (360 kredite europiane ECTS për studimet në fushën e mjekësisë). Kohëzgjatja normale e programeve të integruara të studimeve është jo më pak se 5 vite akademike (6 vite për studimet në fushën e mjekësisë). | **NA** |
| **Standardi II.6 - Institucioni siguron menaxhimin efikas të informacionit në lidhje me programet e studimeve.** | |
| **Kriteri 1** Informacioni i ofruar për programet e studimeve, modulet dhe syllabuset është lehtësisht i konsultueshem për studentët;<br>**Kriteri 2** Informacioni për programet e studimit, modulet dhe syllabuset ofrohet në forma të ndryshme të shkruara dhe elektronike. | Studentët që ndjekin këtë cikël studimesh kanë disa mundësi për të aksesuar informacion e duhur lidhur me modulet, sylabuset, materialet, etc. Këto mundësi janë, sistemi LMS, faqja web e UET, materialet e shkruara dhe elektronike që marin nga pedagogët si dhe biblioteka.<br>GVJ konstatoi nga vizita në IAL se në mbledhjet e departamentit studentët, mund të diskutojnë aspekte të proçesit mësimor, për çështje të programit, rregullores, apo propozime për përmirësim. |
| **Standardi II.8 - Programet e studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë parashikojnë një plan diplomimi.** | |
| **Kriteri 1** Plani i diplomimit shpjegon mënyrën e diplomimit në përfundim të studimeve brenda afatit të parashikuar;<br>**Kriteri 2** Për realizimin e programeve të studimeve "Master i Shkencave" janë parashikuar 30-40 kredite për projektin kërkimor dhe tezën. | Puna për mbrojtjen e diplomës fillon që me plotësimin e kërkesës së studentëve për temë së bashku me zgjedhjen e një pedagogu udhëheqës. Më pas kjo kërkesë shqyrtohet nga Departamenti dhe konkludohet në listën finale të shpërndarjes së diplomave.<br>Sipas RVB, dokumenti për punimin e diplomës është pjesë e Broshurës së Dokumenteve UET dhe përcakton në mënyrë të detajuar planin e diplomimit, që nga momenti i aplikimit për temë diplome, miratimi i temës dhe pedagogut udhëheqës nga departamenti, proçesi i shkrimit të tezës, kalendari i seancave metodologjike e deri tek formatimi konkret i punimit, dorëzimi dhe mbrojtja.<br>Punimi i diplomës është vlerësuar me 14 kredite, në përputhje me kriteret ligjore. |

**Konkluzionet e vlerësimit:**

- GVJ, lidhur me standartet e kërkuara në "*Programin e studimit dhe organizimin e tij*" konstaton se UET ka organizuar një program studimesh të nivelit të dytë në përputhje dhe konform standarteve ligjore në fuqi.
- Ky program studimesh është në përputhje më misionin dhe vizionin e institucionit si se në mbështetje të strategjisë për zhvillim që institucioni ka.
- Programet e studimeve që ofrohen përfshijnë aftësimin profesional të mjaftueshëm dhe synojnë të arrijnë punësim të studentëve në rastet kur nuk janë në marrëdhënie punë.

- Kohëzgjatja dhe numri i krediteve për programet e studimeve të këtij cikli janë në përputhje me Ligjin Nr. 80/2015, datë 21.09.2015, *"Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë"*.
- GVJ konstatoi se UET ka realizuar dhe vazhdon të realizojë analizë tregu dhe e mbështet këtë program studimesh në plotësimin e nevojave që ka tregu për këta specialistë.
- Informimi i studentëve që ndjekin këtë cikël studimesh ka disa mundësi për të aksesuar informacion e duhur lidhur me modulet, sylabuset, materialet, si: sistemi LMS, faqja web e UET, materialet e shkruara dhe elektronike që marin nga pedagogët si dhe biblioteka.
- Lidhur me modulet qe ofrohen në këtë program studimesh, GVJ konstaton se 60% e tyre janë të njëjta me ato që ofrohen në programin e studimeve Master Shkencor në "Administrim Biznesi", me profile.
- GVJ sygjeron qe institudioni të ndërhyjë në programet e moduleve që ofrohen në ketë program studimesh duke i diferencuar ato nga Master Shkencor.

Në përputhje me analizën e realizuar më sipër, bazuar në dokumentacionin e ofruar nga IAL, vizita në institucion dhe dokumentat shtesë të mara në fund të vizitës, GVJ konstaton se **standartet që lidhen me "Programin e studimit dhe organizimin e tij", konsiderohen kryesisht të plotësuara.**

## 8. Mësimdhënia

**Pjesa përshkrimore**

**Terma reference**: organizimi i mësimdhënies, format e mësimdhënies, ngarkesa dhe cilësia e realizimit, kontrolli i njohurive të studentëve, metodat e mësimdhenies, teknologjitë e mësimdhënies, vlerësimi i brendshëm i mësimdhënies, aktivizimi i studentëve në komponentët e aktivitetit të njësisë etj.

GVJ konstatoi se metodat dhe teknikat e mësimdhënies që aplikohen e përdoren për programin e studimit të ciklit të dytë "Master Profesional" në "Menaxhim Biznesi", me profile, janë të shumëllojshme. Krahas formave të mirënjohura të mësimdhënies një drejtimore (nga pedagogu tek studentët), këto metoda tentojnë drejt formave të mësimit me pjesëmarrjen aktive të studentëve dhe strukturimin e ideve të tyre me kontributin e përbashkët pedagog-student. Sipas këtyre metodave, pedagogu është në klasë, jo vetëm në rolin e lektorit, por edhe të një moderatori dhe lehtësuesi të kalimit të dijeve dhe nxitjes së ideve të reja nga ana e studentëve. Disa nga metodat e mësimdhënies që janë përdorur në lëndë të ndryshme, në varësi edhe të natyrës dhe objektivave të formimit janë: Punë në grup, Prezantimet të rasteve nga praktika, diskutim mbi artikujt në revista biznesi, organizimi i lektoriumeve me figura të njohura të fushës, etj.

Studentët bëhen, gjithashtu, pjesë e projekteve të Universitetit, ku mund të përmendim këtu, Panairin e Punës, Aktivitete të ndryshme shkencore, sociale dhe kulturore, etj.

Lëndët e programit të studimit në "Master Profesional" në "Menaxhim Biznesi", me profile, organizohen në 6 kategori disiplinash:

- Kategoria A: Disiplina të formimit të përgjithshëm/bazë
- Kategoria B: Disiplina të formimit karakterizues të programit
- Kategoria C: Disiplina me zgjedhura
- Kategoria D: Disiplina formuese te zgjedhura/kurse te lira
- Kategoria E: Veprimtari formuese
- Kategoria F: Punimi i Diplomës

Në Tabelën 7.2 në anekse jepen edhe të gjithë modulet përkatëse për secilën kategori të përshkruar me sipër.

Lidhur me peshën që zënë secila prej këtyre kategorive në totalin e përgjithshëm të krediteve ato janë në përputhje me kriteret e përcaktuara në aktet nënligjore në fuqi për kohën kur është bërë analiza e programit (Udhëzim nr. 15, dt. 4.4.2008). Konkretisht, modulet e kategorisë A (6 ECTS) përbëjnë 10% të totalit të përgjithshëm të kreditëve të programit. Ndërkohë që modulet e kategorisë B (18 ECTS) përbëjnë 30% të krediteve të përgjithshme, kategoria C (12 ECTS) përbën 20%, kategoria E, ku futet praktika profesionale përfaqëson 16% dhe kategoria F (diploma) 24%. Pesha që zë secila kategori është në përputhje me udhëzimet e Ministrisë, me disa devijime të vogla, për të cilat GVJ nuk mendon se paraqesin problem në ecurinë e programit.

**<u>Vlerësimi i Treguesve të matshëm:</u>**

☑ Llojet e Formave të mësimdhënies, për lëndët/modulet:

- Leksione 168 orë
- Seminare 84 orë
- Ushtrime 108 orë
- Laboratore NA
- Praktikë lëndore NA
- Praktikë profesionale 220 orë
- Diploma 20 orë

☑ Format e kontrollit të njohurive

Format e kontrollit të dijeve të studentit realizohen me anë të disa elementëve; ndjekja e lëndës dhe pjesmarrja aktive, plotësimi i detyrimeve (dorëzim i eseve, detyrave të kursit), testimet gjatë vitit dhe testi përfundimtar. Në detaje këta elementë dhe pesha që ata zënë ndaj totalit të vlerësimit të përgjithshëm jepen në Tabelën 8.3, në Anekse.
Ndërkohë ngarkesa totale në auditor për format e mësimdhënies (Leksione, Seminare, Ushtrime, Praktikë dhe punim diplome) është 600. Këta elementë janë paraqitur në tabelën 8.2 në Anekse.

☑ Aktivizimi i studentëve në komponentët e aktivitetit të njësisë etj

Studentët e UET, janë të angazhuar në jetën e institucionit. GVJ konstatoi se studentët janë pjesë aktive e aktiviteteve të ndryshme si sociale, kulturore, kërkimore e shkencore. Nga vizita në institucion u konstatuan raste kur studentët janë marë me plotësimin e anketave në funksion të studimeve shkencore të stafit pedagogjik.

## 9. Studentët

**<u>Pjesa përshkrimore</u>**

**Terma reference**: procedurat e pranimit të studentëve, cilësia në hyrje e studentëve, numri i studentëve në hyrje dhe në dalje në vite, koha mesatare e zgjatjes së studimeve, kalueshmëria e studentëve dhe problemet që lidhen me të, statistika, punësimi i të diplomuarve, komunikimi me ish-studentët e diplomuar, informimi i studentëve.

GVJ nga takimet me studentët, stafin akademik, stafin mbështetës dhe drejtues, konstatoi se, UET ka në strategjinë e vet, fokusin tek tërheqja e studentëve cilësore drejt programeve të saj, dhe këtë strategji e mbështet dhe e bën të mundur nëpërmjet skemave motivuese financuese, mbi bazën e mesatares të niveleve të mëparshme.
Numri i studentëve të regjistruar në programin "Master Profesional" në "Menaxhim Biznesi", me profile, ka patur lëvizje në vitet e fundit. Tabela përmbledhëse që pasqyron trendin e studentëve në ~~2~~ 6 vitet e fundit akademike jepet në Tabelë 9.1 në Anekse. Nga viti 2014-2015 në vitin 2016-2017, numri total i studentëve është pothuajse njësoj. Ka patur një ritje të konsiderueshme në vitin 2015-2016, deri në 97 studentë.
Zyra e Këshillimit dhe Karrierës mban të dhëna për punësimin e studentëve dhe ruan marrëdhëniet me ta edhe pas mbarimit të programit të studimit, ku qëllimi i saj është jo vetëm ndarja e

eksperiencave dhe arritjeve profesionale të gjithsecilit por edhe krijimin e urave efektive lidhëse midis universitetit e tregut të punës. Disa ndër nga aktivitet që UET ndërmer në kuadër të mbështetjes së studentëve mund të përmendim:

- Panairin e Punës, që i ofron studentëve aktual një mundësi për të kontaktuar drejtpërdrejt me përfaqësuesit e të paktën 52 kompanive të ndryshme në vend,
- Bordet e Tregut të Punës, që shërbejnë si ura lidhëse dhe pika e kontaktit midis praktikës profesionale, tregut të punës dhe internshipeve.

**<u>Vlerësimi i Tregues të matshëm:</u>**

☑ Procedurat e pranimit të studentëve

Universiteti Europian i Tiranës, pranon në nivelin e tij të dytë të studimeve, studentë që vijnë nga niveli i parë i studimeve nga e njëjta fushë apo fusha të ngjashme, të po këtij institucioni si edhe studentë nga IAL të tjera. Sikurse shpjegohet edhe RVB pranohen të regjistrohen ata kandidatë që plotësojnë kushtet si më poshtë:

a) Vërtetojnë me dokument zyrtar zotërimin e diplomës së shkollës së lartë të shoqëruar me çertifikatën e notave që bën të mundur regjistrimin në programin e studimit, sipas legjislacionit në fuqi dhe sipas rregullores së programit të studimit përkatës;
b) Dorëzojnë dokumentet e nevojshme për lidhjen e kontratës me UET-in;
c) Plotësojnë të gjitha kriteret e pranimit të përcaktuara nga organet drejtuese të UET-it;
d) Shtetasit shqiptarë që kanë përfunduar shkollën e larte jashtë vendit, duhet të ndjekin proçedurën e njohjes së diplomës në MASH, në përputhje me legjislacionin në fuqi.
e) Kryejnë pagimin e tarifës së caktuar vjetore dhe/ose të plotë sipas kushteve dhe përcaktimeve të kontratës përkatëse mes UET-it dhe Studentit.

Përzgjedhja bëhet mbi bazë dokumentacioni të dorëzuar nga studentët dhe nga një komision përkatës i caktuar nga Këshilli i Fakultetit.

☑ Cilësia në hyrje dhe në dalje e studentëve

Në këtë program studimesh, cilësia e studentëve në hyrje nuk kontrollohet nga kufiri i mesatares si kusht regjistrimi. Statistikat lidhur me cilësinë e studentëve jepen në Tabelën 9.3 në Anekse.

☑ Studentë të regjistruar në vitin e Parë (për herë të parë).

Statistika e mara nga IAL lidhur me numrin e studentëve të regjistruar në vitin e Parë (për herë të parë) dhe transferimet, jepen në Tabelën 9.2 në Anekse.

☑ Të dhëna për punësimin e studentëve

Lidhur me punësimin e studentëve, UET disponon të dhëna dhe statistika të rregullta prej disa vitesh. Gjatë vizitës në institucion, GVJ iu vunë në dispozicion këto statistika që në mënyrë të përmbldhur jepan në Tabelën 9.4 në Anekse. Vihet re që në 4 vitet e fundit për të cilët janë marë këto statistika, përqindja e të punësuarve sipas profilit të diplomës së tyre luhatet midis 10-33%.

☑ Numri total i të punësuarve (në përputhje me diplomën)

Statistika e mara nga IAL lidhur me numrin total i të punësuarve në përputhje me diplomën dhe jo me diplomën, jepen në Tabelën 9.4 në Anekse. Vihet re se numri i të dilomuarve në përputhje me dilomën është disa herë më i lartë se ai jo në përputhje me diplomën, sidomos për vitin 2014-2015 ky numër është shumë i lartë.

**<u>Vlerësimi sipas Standardeve</u>**

| Standardi/Kriteret | Vlerësimi sipas standardeve |
|---|---|

| **Standardi IV.1 - Studentët kanë të drejtë të ndjekin programet e studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë.** | |
|---|---|
| **Kriteri 1** Studentët që ndjekin programet e studimeve "Master i Shkencave" apo "Master Profesional" zotërojnë së paku diplomën universitare "Bachelor" dhe kanë grumbulluar 180 kredite ECTS;<br>**Kriteri 2** Pranimi në programet e integruara të studimeve bëhet në përputhje me ligjin nr. 9741, datë 21.5.2007, "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar dhe akteve nënligjore në fuqi;<br>**Kriteri 3** Studentët plotësojnë kriteret e pranimit të përcaktuara nga institucioni;<br>**Kriteri 4** Studentët e këtyre programeve të studimit japin deri në diplomim edhe provimin e gjuhës angleze mbi bazën e testeve të njohura ndërkombëtare. Për programet e studimeve "Master Profesional" niveli i gjuhës angleze është B2, ndërsa për programet e studimeve "Master i Shkencave" dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë niveli i gjuhës angleze është C1, sipas Kuadrit Europian të Gjuhëve;<br>**Kriteri 5** Institucioni vlerëson herë pas here politikat e pranimit dhe ndikimin e tyre në përparimin e mëtejshëm të studentëve në programin e studimit, si dhe harton plane të mundshme për ndryshimin e kritereve të pranimit. | Të gjithë studentët që janë të regjistruar në ciklin e dytë të studimeve, kanë përfunduar paraprakisht një cikël studimesh të nivelit të parë me së paku 180 ECTS.<br><br>Pranimi dhe regjistrimi i kandidatëve në programin e ciklit të dytë "Master Profesional" në "Menaxhim Biznesi", me profile, kryhet sipas udhëzimeve të MAS, në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi.<br><br>Nga institucioni nuk përdoren kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve. |
| **Standardi IV. 2- Institucioni informon studentët në lidhje me: statusin e institucionit, të programeve të studimeve që ofron dhe me politikat e punësimit.** | |
| **Kriteri 1** Studentëve u jepet informacion për mundësitë për punësim pas diplomimit në përfundim të këtyre programeve të studimeve;<br>**Kriteri 2** Studentëve u jepet informacion për akreditimin e institucionit dhe të programeve të studimeve që ofrohen si edhe për njohjen dhe vlefshmërinë, brenda dhe jashtë vendit, të diplomës së lëshuar nga ky institucion;<br>**Kriteri 3** Studentëve u ofrohet shërbimi i këshillimit të karrierës. | Pranë Institucionit ishte ngritur Zyra e Këshillimit të Karrierës. Zyra e Karrierës është aktive, dhe ofron shërbimin e këshillimit për karrierën të studentëve.<br><br>Gjithashtu strukturat drejtuese, si Përgjegjësat e Departamenteve, Dekanati dhe Alumni, ofrojnë mbështetje për punësim të studentëve si gjatë studimeve dhe pas mbarimit.<br><br>Studentët janë të mirëinformuar lidhur me proçesin e akreditimit dhe pozicionin që ka UET lidhur me këtë aspekt të Arsimit të Lartë. |
| **Standardi IV. 3- Institucioni, kur aplikon për vlerësimin dhe akreditimin për herë të dytë, disponon statistika në lidhje me numrin e studentëve që ndjekin programet e studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë.** | |
| **Kriteri 1** Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e të diplomuarve në programet e studimeve që kanë përfunduar;<br><br>**Kriteri 2** Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimeve të ciklit të dytë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, tërheqjet | Gjatë vizitës në institucion u konstatua se UET ka statistika për numrin e të diplomuarve. Këto të dhëna raportohen çdo vit pranë Drejtorisë së Statistikave në MAS. Ndërkohë të dhënat e të diplomuarve mbahen në regjistrin përkatës. |

| | |
|---|---|
| nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik;<br><br>**Kriteri 3** Institucion disponon të dhëna për ecurinë akademike të studentëve që nga pranimi deri në diplomim. | Universiteti Europian i Tiranës mban statistika vjetore të rregullta për numrin e të regjistruarve në programin e ciklit të dytë të studimit. GVJ ju vendosën në dispozicion statistika rreth studentëve të regjistruar në vite dhe ecurisë së tyre. (*Tabela 9.1 në Anekse*)<br><br>UET disponon në formë elektronike dhe të shkruar, të dhëna për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit studimor që nga pranimi deri në prag të diplomimit, dokumentacion ky që u verifikua edhe nga GVJ gjatë vizitës inspektuese në institucion.<br><br>Regjistri i themeltar, Regjistri i notave, Regjistri i diplomave janë dokumentet bazë që pasqyrojnë këto statistika. |
| **Standardi IV. 4- Institucioni disponon një bazë të dhënash në lidhje me statistikat e punësimit të studentëve që janë diplomuar pas përfundimit të programeve e studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë.** | |
| **Kriteri 1** Institucioni mban një bazë të dhënash të studentëve të punësuar pas përfundimit të programeve të studimeve të ciklit të dytë apo të programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë si dhe për vendet e punësimit të tyre;<br><br>**Kriteri 2** Institucioni mban një bazë të dhënash për studentët që vazhdojnë studimet e mëtejshme në ciklet e tjera të studimeve etj. | Universiteti Europian i Tiranës, nëpërmjet Zyrës së Karrierës mban të dhëna të përditësuara, bazuar në kontaktin e vazhdueshëm me studentët, në lidhje me studentët e punësuar pas përfundimit të këtij programi studimi. (*Tabela 9.4 në Anekse*)<br><br>Një rol të rëndësishëm në mbajtjen e statistikave të punësimit ka dhe Alumni, me përfaqësuesit e së cilës zhvillohen takime të vazhdueshme për të marrë mendime në lidhje me përmirësimet e mundshme që do të duhet të bëhen në organizimin dhe ofertën akademike të institucionit për t'iu përshtatur më mirë kërkesave të tregut të punës dhe zhvillimeve bashkëkohore në Europë e më gjerë. |
| **Standardi IV. 5- Institucioni informon studentët në mënyrë të vazhdueshme dhe të detajuar, në lidhje me programet e studimeve.** | |
| **Kriteri 1** Studentët informohen në mënyrë të detajuar për programet e studimeve, afatin e përfundimit dhe organizimin e programit, statusin e akreditimit të programit;<br><br>**Kriteri 2** Studentët informohen për rezultatet e vlerësimit gjatë dhe në përfundim të programit;<br><br>**Kriteri 3** Përgjegjësi i modulit diskuton hapur me studentët rezultatet e këtyre vlerësimeve. | Gjatë vizitës në institucion, GVJ konstaton se që në momentin e interesimit dhe më pas të regjistrimit dhe në vijimësi studentët informohen për programin e studimit. Informacioni i nevojshëm ndodhet në faqen e internetit të universitetit, në sistemin online që kanë studentët LMS, u dërgohet elektronikisht përmes adresave elektronike që u jepen studentëve që në regjistrim, ofrohet nga personeli ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ si edhe shpallet në tabelat e njoftimeve. |

<table>
<tr><td></td><td>Që në fillim të çdo moduli, studentët njihen me strukturën e tij se dhe me mënyrat e vlerësimit.<br>Pikët e marra për çdo aktivitet të mësimdhënies si dhe pikët e marra në provimin final studentit i dërgohen me anë të sistemit LMS.<br>Pas çdo provimi, pedagogët zhvillojnë seanca sqaruese me studentët, për të sqaruar çdo paqartësi të mundshme në lidhje me vlerësimin e kryer. Pas kësaj seance pedagogu dorëzon proçesverbalin me rezultatet e studentëve. Procesverbalet gjenerohen nga sistemi UMIS.</td></tr>
<tr><td colspan="2">Standardi IV. 6- Institucioni angazhon personelin e tij për përkujdesjen ndaj studentëve.</td></tr>
<tr><td>Kriteri 1 Institucioni u ofron këshillim studentëve, ndjek ecurinë e tyre dhe i ndihmon për trajtimin dhe zgjidhjen e çështjeve dhe problematikave që lidhen me procesin mësimor;<br><br>Kriteri 2 Institucioni (nëpërmjet zyrës për këshillimin e karrierës) ndihmon studentët në përzgjedhjen e institucionit në të cilin ata do të zhvillojnë praktikën profesionale, në rastet kur parashikohet një e tillë.</td><td>UET ka ngritur një strukturë të veçantë për Këshillimin e Karrierës, që ofron shërbimin e këshillimit për studentët. Progresi i tyre ndiqet dhe ndihmohet nga departamenti përkatës, i cili bashkëpunon me sekretarinë mësimore për të siguruar informacionin e nevojshëm.<br>Zyra e Karrierës është një njësi aktive që funksionon brenda strukturës së Institucionit. Studentët shprehën kënaqësinë e tyre për asistencën që kjo zyre ofron.<br>Gjithashtu një strukturë tjetër mbështetëse për studentët është dhe Zyra e Kujdesit ndaj Studentit, e cila ndjek ecurinë e studimeve të studentit, që nga momenti i regjistrimit deri në diplomimin e tij duke ofruar konsulencë për çështje akademike dhe studentore.</td></tr>
<tr><td colspan="2"><u>Konkluzionet e vlerësimit:</u><br>- Në përputhje me kriteret ligjore në fuqi, studentët kanë të drejtë të ndjekin programet e studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë në UET.<br>- Institucioni informon studentët në lidhje me statusin e institucionit, të programeve të studimeve që ofron, si dhe me politikat e punësimit.<br>- Institucioni disponon statistika në lidhje me numrin e studentëve që ndjekin programet e studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë.<br>- GVJ konstatoi se UET disponon një bazë të dhënash në lidhje me statistikat e punësimit të studentëve që janë diplomuar pas përfundimit të programeve e studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë.<br><br>Në përputhje me analizën e realizuar më sipër, bazuar në dokumentacionin e ofruar nga IAL, vizita në institucion dhe dokumentat shtesë të mara në fund të vizitës, GVJ konstaton se standartet që lidhen me "Studentët", konsiderohen të plotësuara.</td></tr>
</table>

# KËRKIMI SHKENCOR NË FUNKSION TË PROGRAMIT TË STUDIMIT.

## 10. Kërkimi shkencor

**Pjesa përshkrimore**

**Terma reference**: politikat e kërkimit shkencor në këtë program studimi, botimet në vite, projektet e fituara dhe të realizuara, pjesëmarrja në aktivitetet brenda dhe jashtë vendit, aktivitetet e organizuara nga njësia, lidhja e kërkimit me mësimdhënien.

UET ka krijuar hap pas hapi të gjithë infrastrukturën e nevojshme për të nxitur dhe mbështetur veprimtarinë kërkimore-shkencore ndërdisiplinore cilësore të strukturave të UET-së, partnerëve të tyre jashtë dhe brenda Shqipërisë, si dhe për të mundësuar tek të gjithë të interesuarit zhvillimin e standardeve dhe përftimin e atyre njohurive, aftësive dhe kompetencave, që i bëjnë eficientë, të suksesshëm dhe që u mundësojnë zhvillimin shkencor. Duke u mbështetur edhe në Statutin e tij, UET e konsideron kërkimin shkencor dhe inovacionin si një nga pilarët kryesorë të mirëfunksionimit të tij. Përveçse një institucion akademik, UET e konsideron veten edhe institucion kërkimor-shkencor që synon të jetë qendra të ekselencës për kërkimet ndërdisiplinore në fushat që lidhen me proçeset sociale, ekonomike, aplikimeve të teknologjisë së informacionit dhe të mjedisit.

Nga vizita në IAL, GVJ konstatoi se prej vitit akademik 2010-2011, UET ka një pozicion të dedikuar për Kërkimit Shkencor, posti i Zv/Rektorit për Kërkimin Shkencor dhe Metodologjinë. Sipas intervistave me stafin drejtues të UET, posti i Zv. Rektorit për Kërkimin Shkencor dhe Metodologjinë, synon koordinimin e gjithë hallkave të kërkimit shkencor që nga fakultetet/departamentit, Zyra Doktorale dhe pasurimi i përhershëm i bibliotekës, si dhe ruajtja e standardeve të botimit në revistat shkencore të UET-it.

Universiteti Europian i Tiranës ofron për stafin akademik një program trajnimi të strukturuar në përputhje me gradën shkencore dhe angazhimin në hulumtim. Trajnimi është i organizuar në seminare tre-ditore që ofrohen në fund dhe fillim të kalendarit akademik. Si pjesë e ristrukturimit të revistave shkencore dhe përmirësimit të vazhdueshëm të produktit të kërkimit shkencor, UET ofron trajnime për botimin (në revista kombëtare dhe ndërkombëtare) dhe kryerjen e kërkimeve në grup për stafin akademik. Universiteti Europian i Tiranës siguron mbështetje financiare për kërkimin shkencor të stafit të saj akademik. Stafi akademik i UET është i inkurajuar që të hulumtojë dhe të publikojë dhe në bazë të performancës marrin grantet e tyre kërkimore. Marrja apo jo e grantit është në përputhje me plotësimin e një sistemi pikëzimi që duhet të bëjë stafi. Në këtë sistem pikëzimi përfshihen një sërë aktivitetesh të ndryshme gjatë vitit akademik. Sasia e pikëve është në vartësi të gradës shkencore të stafit, për të arritur një maksimum prej 100 pikësh për Profesoratin. Sipas UET, lidhja e shpërblimit financiar me arritje të matshme akademike është një mekanizëm i përshtatshëm për të kontrolluar dhe inkurajuar veprimtarinë shkencore dhe botimet. Gjatë vizitës në institucion, organet drejtuese u shprehen se momentalisht ky sistem grantesh është nën ristrukturim duke ndryshuar skemën e dhënies së këtij granti, i cili u jepet stafit akademik nëse ata publikojnë apo marin pjesë në evente të rëndësishme ndërkombëtare dhe publikojnë në revista të indeksuara në Skopus apo Thomson&Reuters.

Për ti ardhur në ndihmë stafit të saj por jo vetëm, UET publikon dy revista shkencore ndërkombëtare: Economicus (ISSN: 2223-6295) (http://www.uet.edu.al/economicus/) dhe Polis (ISSN: 2223-8174) (http://www.uet.edu.al/polis/). "Economicus" publikon kërkime në fushën e ekonomisë, zhvillimit dhe IT, ndërsa "Polis" publikon kërkime në fushën e shkencave humane dhe shoqërore. Revistat publikojnë artikuj vetëm në gjuhën angleze, mbështeten në një proces 'double blind peer revieë' dhe kanë faqet e internetit të dedikuara ku kërkues të ndryshëm do të mund të publikojnë artikujt pa pagesë.

**Vlerësimi i Treguesve të matshëm:**

☑ Të dhëna për kërkimin shkencor

Të dhënat lidhur me kërkimin shkencor, botimet e realizuara, projektete e fituara dhe të zbatuara, aktivitetet shkencore të realizuara dhe studentët e përfshirë në kërkim, jepen në Tabelën 10.2 në Anekse.

☑ Numri i Çmimeve Kombëtare
Nuk raportohen çmime të mara nga anëtarë të Departamentit që ofrohet ky program studimesh.

☑ Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion
Nga vizita në institucion u morën këto dokumente shtesë:

- "Strategjia e kërkimit shkencor" (*Dokument nr. 2, Vizita në Institucion*),
- komunikimi për hartimin dhe miratimin e strategjisë së kërkimit,
- formatet e vlerësimit të pedagogut (*Dokument nr. 8, Vizita në Institucion*),
- bashkëpunimi pedagog student në kuadër të kërkimit shkencor.

**Vlerësimi sipas Standardeve**

| Standardi/Kriteret | Vlerësimi sipas standardeve |
|---|---|
| **Standardi III.3 - Personeli akademik angazhohet në veprimtari shkencore të organizuara në kuadër të programit të studimeve.** | |
| **Kriteri 1** Personeli akademik publikon rregullisht artikuj, materiale shkencore në disiplinën përkatëse;<br>**Kriteri 2** Personeli akademik, nëpërmjet angazhimeve në këto veprimtari jep ndihmesën e tij në zhvillimin e shkencës ose në zhvillimin e sektorëve të prodhimit apo të shërbimit. | GVJ konstatoi se personeli akademik i IAL është i angazhuar në kërkim shkencor dhe në publikime të ndryshme në evente kombëtare dhe ndërkombëtare.<br>Institucioni ka aplikuar një grant për kërkimin shkencor që ka qënë në dispozicion të personelit akademik mbi bazën e një sistemi pikësimi. (*Dokumenti nr. 4, Vizita në Institucion*)<br>Aktualisht UET e ka ndryshuar skemën e dhënies së këtij granti, i cili u jepet stafit akademik nëse ata publikojnë apo marin pjesë në evente të rëndësishme ndërkombëtare dhe publikojnë në revista të indeksuara në Skopus apo Thomson&Reuters, në përputhje me kriteret ligjore në fuqi.<br>Gjithashtu UET ka në strukturat e tij edhe 2 revista shkencore, "Economicus" dhe "Polis", ku stafi mund të publikojë dhe të promovojë studimet e realizuara. |
| **Standardi III.4 - Institucioni ofron programe mësimdhënieje edhe në gjuhë të huaj, me një personel akademik të kualifikuar.** | |
| **Kriteri 1** Personeli akademik që angazhohet në mësimëdhënie në gjuhë të huaj ka kryer studimet universitare në atë gjuhë ose zotëron një çertificate për njohje të avancuar të saj;<br><br>**Kriteri 2** Personeli akademik që angazhohet në mësimëdhënie në gjuhë të huaj ka një përvojë në mësimdhënie në atë gjuhë, prej së paku një semestri. | GVJ, duke konsultuar RVB si dhe vizitën në institucion konkludoi se në UET nuk ka patur zhvillim të lëndëve në gjuhë të huaja. Megjithëse ka patur disa mobilitete studentësh të ardhur në UET në kuadër të programit Erasmus+ janë zhvilluar në gjuhë të huaj nga ana e pedagogëve përkatës, seanca personale të përqëndruara. Në fund studentët e ardhur kanë dhënë provimin |

| | |
|---|---|
| | final më një tezë të personalizuar në anglisht.<br>Në përbërje të departamentit ka pedagogë të cilët përmbushin kriteret dhe kanë ofruar disponibilitetin e tyre për të zhvilluar mësimdhënien në gjuhë të huaj në bazë të eksperiencës dhe kualifikimeve që ata disponojnë.<br>Vlen të thekësojmë se në kuadër të këtij programi studimesh në "Master Profesional", nuk ka patur mobilitete të studentëve në kuadër të ERASMUS+, ndërkohë që ka patur mobilitete të stafit pedagogjik. |
| **Standardi III.10 - Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe të mëtejshëm të personelit të tij.** | |
| **Kriteri 1** Institucioni organizon programe specifike për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimor-shkencor;<br><br>**Kriteri 2** Institucioni u ofron personelit akademik dhe atij mësimor-shkencor mundësinë e kualifikimeve të mëtejshme brenda dhe jashtë vendit. | Universiteti Europian i Tiranës organizon në mënyrë periodike Ditën e Zhvillimit të Stafit- Staff Development Day. Synimi i këtij organizimi është trajnimi i stafit në fusha të lidhura me mësimdhënien, kërkimin, projektet, metodologjinë, etj. Këto trajnime bëhen duke u bazuar në kualifikimet dhe gradat që stafi akademik disponon dhe kryesisht targetojnë stafin MSc dhe Dr.<br>Një rol të rëndësishëm për mundësinë e kualifikimeve të mëtejshme brenda dhe jashtë vendit të stafit luan dhe Zyra e Zhvillimit të Projekteve dhe Kërkimit në UET. Kjo zyrë përgatit dhe shpërndan tek personeli akademik informacion në lidhje me mundësi aplikimi për programe kërkimore, trajnime dhe kualifikime si dhe ofron konsulencë për zhvillimin e aplikimeve. Ndërkohë që puna kërkimore shkencore kordinohet së pari nëpër departamentet përkatëse. |
| **Standardi III.11 - Institucioni disponon një bazë të dhënash në lidhje me veprimtarinë kërkimore-shkencore të personelit akademik të tij.** | |
| **Kriteri 1** Institucioni disponon një bazë të dhënash të studimeve shkencore të personelit akademik të angazhuar në këtë program studimi;<br>**Kriteri 2** Institucioni disponon një bazë të dhënash për botimet (tekste, monografi, libra, artikuj apo kumtesa në konferenca) brenda e jashtë vendit të personelit akademik të angazhuar në këtë program studimi;<br>**Kriteri 3** Institucioni disponon një bazë të dhënash për projektet kërkimore shkencore kombëtare e ndërkombëtare në të cilat ka marrë ose merr pjesë personeli akademik i angazhuar në këtë program studimi. | Çdo departament realizon në fillim të vitit planin individual të stafit lidhur me kërkimin shkencor, publikimet dhe pjesëmarjen në projekte. Në fund të vitit bëhet realizimi i planit dhe shihet ecuria e secilit. GVJ vlerëson se UET ka statistika përmbledhëse të aktivitetit kërkimor shkencor të stafit të tij (*Tabela 10.2 në Anekse*)<br>Sipas RVB dhe konstatimeve të bëra në IAL, GVJ konkludon se Zyra e Zhvillimit të Projekteve dhe Kërkimit në UET disponon një bazë të dhënash me detaje të projekteve kërkimore, zhvillimi, ndërtim-kapacitetesh etj. në të cilat ka marrë pjesë ose është |

| | |
|---|---|
| | aktualisht i përfshirë personeli akademik, si dhe me detaje të projekteve në aplikim/të ardhshme. Baza e të dhënave përmban: detaje për projektin; për donatorin; për partnerët; për personelin akademik të përfshirë; etj. |

**Konkluzionet e vlerësimit:**

- Në mbështetje të kërkimit shkencor, GVJ konstatoi se personeli akademik në UET angazhohet në veprimtari të ndryshme shkencore të organizuara në kuadër të programit të studimeve.
- Gjithashtu vetë institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe të mëtejshëm të personelit të tij, si dhe disponon një bazë të dhënash në lidhje me veprimtarinë kërkimore-shkencore të personelit akademik.
- UET aplikon një skemë grantesh për kërkimin shkencor.
- Aktualisht ky grant i jepet stafit akademik nese ata publikojnë apo marin pjesë në evente të rëndësishme ndërkombëtare dhe publikojnë në revista të indeksuara në Skopus apo Thomson&Reuters.
- UET ka në strukturat e tij edhe 2 revista shkencore, "Economicus" dhe "Polis", ku stafi mund të publikojë dhe të promovojë studimet e realizuara.
- Institucioni duhet të punojë më shumë lidhur me ofrimin e programeve të mësimdhënies në gjuhë të huaj. Duke qënë se aktualisht UET ka një sërë marëveshjesh në kuadër të ERASMUS+, duhet të punojë lidhur dhe me mundësinë e ofrimit të kurseve në anglisht.

Në përputhje me analizën e realizuar më sipër, bazuar në dokumentacionin e ofruar nga IAL, vizita në institucion dhe dokumentat shtesë të mara në fund të vizitës, GVJ konstaton se **standartet që lidhen me "Kërkimin Shkencor", konsiderohen të plotësuara**.

## 11. Bashkëpunimi kombëtar, ndërkombëtar dhe marrëdhëniet me publikun

**Pjesa përshkrimore**

> **Terma reference**: bashkëpunimi me institucionet e tjera në nivel lokal, kombëtar apo ndërkombëtar, mobiliteti i personelit akademik në secilin nga nivelet e sipërpërmendura, pjesëmarrja në programe kombëtare dhe ndërkombëtare, lidhjet me komunitetin e biznesit dhe me tregun e punës.

Nga vizitat inspektuese në Universitetin Europian të Tiranës, rezultoi se ky institucion, ka vendosur marrëdhënie me shumë institucione akademike kombëtare dhe ndërkombëtare, shoqëri tregtare private, si prioritet i lidhjes së teorisë me praktikën, prioritet i shprehur dhe në misionin e tij. Në UET, angazhimi akademik është i lidhur ngushtë me bashkëpunimin ndërkombëtar. Një bashkëpunim shumë i frytshëm i UET është ai me Universitetin e Aston-it në Britaninë e Madhe në kuadër të programeve të Shkollës Doktorale, mbi bazën e të cilit bëhen shkëmbime programesh, pedagogësh e studentësh. UET ka marëveshje bashkëpunimi në kuadër të projekteve Tempus, Jean Monnet, Erasmus+, si edhe si dhe me institucioneve të tjera në kuadër të programeve mbështetëse për kërkimin shkencor nga donatorë të ndryshëm ndërkombëtar dhe lokal si Agjencitë e UN, Assist Impact/USAID, American-Albanian Development Fund, Fondacioni Shoqëria e Hapur, Regional Research Promotion Programme; NUFFIC, Sëiss Development Cooperation, etj. Universiteti Europian i Tiranës, ka marëveshje bashkëpunimi me shumë universitete jashtë vendit ku mund të përmendim, La Sapienza University of Rome, University of Padova, University of Bari, University of Bolonja Itali; Central European University, Budapest; si

dhe disa universite kombëtare. Sidomos në kuadër të marëveshjeve ERASMUS+, UET ka realizuar një serë mobilitetesh në staf (mësimdhënie dhe trajnim) dhe në studentë.

Për tu thekësuar është ngritja dhe mirëfunksionimi i Zyrës së Projekteve, si një njësi e veçantë brënda kësaj IAL. Nga vizita që GVJ realizoi në institucion si dhe nga takimet e realizuara me stafin,studentët dhe njësitë drejtuese të kësaj zyre, u konstatua se kjo njësi funksionon shumë mirë brënda UET. Ajo jep informacion të vazhdueshem lidhur me mundësitë e ndryshme për aplikime, bën lidhje midis aktorëve të interesuar si dhe koordinon mbarëvajtjen e vazhdueshme të projekteve në UET.

Universiteti Europian i Tiranës është pjesë e Rrjeteve Ndërkombëtare të Universiteteve si SEUN-Rrjet partnerësh mbi startup, sipërmarrjen rinore dhe inovacionin (Spanjë); UNIMED- Rrjet universitetesh mesdhetare me qëllim shkëmbimin e stafit dhe studentëve (Itali); FEDE-Rrjet europian universitetesh me qëllim kërkimin shkencor (Portugali). Gjithashtu që prej vitit 2014-2015, UET është pjesë i rrjetit 'Next", i cili synon të trajtojë me përparësi problematikën e demokratizimit, zhvillimit ekonomiko-shoqëror dhe institucional të vendeve të Ballkanit Perëndimor, Europë. Vlen të thekësohet dhe ngritja e Bordeve e Punës pranë secilit departament në Fakultetet përkatëse edhe organizimi një herë në vit i Panairit të Punës, si dhe rrjetin e Alumni.

Sikundër është thekësuar edhe RVB, mbështetur dhe në vizitën në institucion, GVJ konstatoi se mobiliteti i stafit akademik dhe studentëve realizohet në kuadër të projekteve si Erasmus+ KA1 dhe KA2 të Komisionit Europian; të projekteve kërkimore dhe rrjetëzimit si COST dhe Horizon 2020 të Komisionit Europian; Visegrad University Fund në bazë të marrëveshjeve të veçanta me institucione të tjera në kuadër të thirrjeve të projekteve kërkimore bilaterale si Shqipëri-Austri dhe Shqipëri-Turqi etj (aplikuar nga AKTI); sipas aplikimeve individuale të stafit për të kryer periudha kërkimore në universitete të tjera jashtë. Sipas të dhënave të mara në institucion mobilitetet gjatë viteve 2015-2017 kanë qënë: **107 mobilitete staf dhe student nga UET drejt Universiteteve partnere**, dhe **18 staf dhe 13 studentë kanë ardhur në UET përmes bursave Erasmus+** gjatë **2015-2017**.

**<u>Vlerësimi i Treguesve të matshëm:</u>**

☑ Të dhëna për bashkëpunimin kombëtar dhe ndërkombëtar, në nivel Universiteti

- Numri i pjesëmarrësve si partnerë në projekte Kombëtare apo ndërkombëtare 13
- Numri i Leksioneve dhe seminareve me lektorë të huaj 37
- Numri i pjesëmarrësve në trainime fushën e kërkimit shkencor jashtë vendit 30
- Mobiliteti i studentëve nga dhe drejt IAL 70
- Infrastruktura në funksion të kërkimit shkencor (shiko me poshtë)
- Numri i pjesëmarrësve në aktivitete shkencore Jashtë IAL/ jashtë vendit dhe prezantime 21

Lidhur me mobilitet e studenteve të UET, nga dhe drejt këtij institucioni u konstatua se:
13 studentë kanë ardhur në UET përmes programeve Erasmus+, 38 studentë nga UET kanë përfituar nga marëveshjet Erasmus+, 19 studentë të UET kanë lëvizur përmes programeve të tjera të BE (SIGMA) dhe programeve bilaterale.

Lidhur me infrastrukturën në funksion të kërkimit shkencor, u konstatua se UET zotëron:
Bibliotekën, Abonimin në EBSCO, SAGE online si edhe të tjera burime online; Laborator IT; infrastrukturë anti-plagjarizëm; Salla konferencash dixhitale; UET zhvillon në mënyrë periodike trajnimin e stafit të brendshëm akademik: Kërkimi me Impakt; Si të komunikojmë Shkencën; UET Research group; Si të aplikojmë për projekte; etj. Ditët Doktorale; Revistat Shkencore (Economicus dhe Polis); Ditë Informative për grante kërkimore në nivel Europian (AKTI, RCE, etj.); Ditët e Studimeve Shqiptare.

**<u>Vlerësimi sipas Standardeve</u>**

| **Standardi/Kriteret** | **Vlerësimi sipas standardeve** |
|---|---|
| **Standardi V. 3- Institucioni ka marrëdhënie bashkëpunimi me aktorë të biznesit vendas apo të huaj për kryerjen e praktikave të studentëve të tij.** | |
| **Kriteri 1** Për kryerjen e praktikave të ndryshme të parashikuara për realizimin e programit të studimeve "Master Profesional", institucioni dëshmon se ka marrëdhënie bashkëpunimi me ndërmarrje apo sipërmarrje nga fusha e tregtisë, industrisë apo e shërbimeve prodhuese;<br><br>**Kriteri 2** Për kryerjen e praktikave të ndryshme në programin e studimeve "Master i Shkencave" ose në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, institucioni dëshmon se ka marrëdhënie bashkëpunimi me aktorë të ndryshëm nga sfera publike dhe ajo private që mundësojnë përfitimin e njohurive më të mira profesionale nga ana e studentit. | UET ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me punëdhënësit të ndryshëm privatë dhe publikë, për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të programeve të studimeve që ofrojnë. UET, ka marrëdhënie bashkëpunimi me biznese brenda vendit, por njëkohësisht edhe partnerë të huaj, të cilët organizojnë lektoriume dhe trajnime për përshtatjen sa me të mirë të studentëve më tregun e punës. Duhet të thekësohet prania e Bordeve të Punës pranë secilit departament në Fakultetet përkatëse edhe organizimi një herë në vit i Panairit të Punës. Në kuadër të programit të studimeve "Master Profesional", pjesa më e madhe e studentëve janë në mardhënie pune dhe ky fakt e lehtëson shumë angazhimin e tyre në praktikën profesionale.<br><br>NA |
| **Standardi VII.1 - Institucioni garanton marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi mes personelit të tij.** | |
| **Kriteri 1** Institucioni, për hartimin dhe mbikëqyrjen e programit, nxit bashkëpunimin ndërmjet personelit brenda institucionit nëpërmjet shkëmbimit të informacionit;<br>**Kriteri 2** Institucioni, nëpërmjet ndarjes së detyrave mes personelit Brenda institucionit, marrjes së përgjegjësive respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre, garanton marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi. | UET për hartimin dhe mbikëqyrjen e programit, nxit bashkëpunimin ndërmjet personelit brenda institucionit nëpërmjet shkëmbimit të informacionit. Nga vizita, si dhe nga dokumentat e kërkuara si dhe nga minutat e mbledhjeve, GVJ konstaton se në UET ekziston një proçes nga poshtë lart lidhur me vendosjen e prioriteteve në kërkim, si dhe bashkëpunimet për projekte të ndryshme.<br><br>Referuar raporteve vjetore të vëna në dispozicion rezulton se UET organizon takime e analiza për aspekte të ndryshme duke garantuar bashkëpunimin e anëtarëve të stafit. |
| **Standardi VII.2 - Institucioni garanton marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe jashtë vendit dhe aktorët e biznesit vendas ose të huaj.** | |
| **Kriteri 1** Institucioni për realizimin e objektivave të programeve të studimeve ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe jashtë vendit dhe aktorët e biznesit vendas ose të huaj;<br>**Kriteri 2** Institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të programeve të studimeve që ofron;<br>**Kriteri 3** Institucioni organizon trajnime profesionale të mëtejshme në bashkërendim me punëdhënësit; | Nga dokumentet e siguruara pranë UET, rezultojnë 94 marrëveshje mes UET dhe universiteteve ndërkombëtare, 15 marrëveshje mes UET dhe universiteteve kombëtare si dhe 16 donatorë kombëtare dhe ndërkombëtare. (*RVB, Dokumenti nr. 17, dokumentacioni i vetëvlerësimit*)<br><br>UET ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të programeve të studimeve që ofrojnë, megjithatë GVJ konstatoi nga vizita në institucion se nuk ekzistojnë kontrata të |

| | |
|---|---|
| **Kriteri 4** Institucioni bën një raport analitik të përfitimeve nga marrëveshjet kontraktuale në funksion të realizimit të programeve të studimeve. | shkruara për këtë bashkëpunim. Pengesë për nënshkrimin e kontartave, sipas institucionit, janë ndryshimet e kuadrit ligjor ku bizneset qe marin në ngarkim studentët me praktikë duhet ti deklarojnë dhe të paguajnë sigurime për ta.<br><br>UET, ka marrëdhënie bashkëpunimi me biznese brenda vendit, por njëkohësisht edhe partnerë të huaj, të cilët organizojnë lektoriume dhe trajnime për përshtatjen sa me të mire të studentëve më tregun e punës. |

**Konkluzionet e vlerësimit:**

- Lidhur me bashkëpunimin kombëtar dhe ndërkombëtar, UET ka marrëdhënie bashkëpunimi me IAL në vend dhe jashtë. Këto marëdhënie janë konkretizuar me implementimin e projekteve të ndryshme bashkëpunimi apo me mobilitete të stafit akademik dhe studentëve, në të dy drejtimet.
- Gjithashtu UET bashkëpunon me aktorë të biznesit vendas apo të huaj për kryerjen e praktikave të studentëve të tij dhe e ka bërë pjesë të analizave të tij ecurinë e këtyre marrëveshjeve.
- UET për realizimin e objektivave të programeve të studimeve ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe jashtë vendit dhe aktorët e biznesit vendas ose të huaj.
- GVJ arriti në përfundimin se përfshirja e UET në një game të gjerë dhe të larmishme bashkëpunimesh dhe partneritetesh ofron mundësi më të shumta për pjesëmarrjen e personelit dhe studentëve në evente kombëtare dhe ndërkombëtare siç janë konferencat, simpoziumet, konkurset, ëorkshopet, krahas atyre që organizohen nga vetë UET.

Në përputhje me analizën e realizuar më sipër, bazuar në dokumentacionin e ofruar nga IAL, vizita në institucion dhe dokumentat shtesë të mara në fund të vizitës, GVJ konstaton se **standartet që lidhen me "Bashkëpunimin kombëtar, ndërkombëtar dhe marrëdhëniet me publikun", konsiderohen të plotësuara.**

## ANALIZA PËRMBLEDHËSE PËR VLERËSIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

### I. ANALIZA PËRMBLEDHËSE PËR PLOTËSIMIN E REKOMANDIMEVE NGA AKREDITIMI I PARË

Institucioni ka marrë një sërë rekomandimesh nga akreditimi i parë i programit Master Profesional në Menaxhim Biznesi, me profile. Bazuar në këto rekomandime, IAL ka punuar drejt plotësimit të tyre në vazhdimësi dhe paralel me punën e saj. Nga tërësia e rekomadimeve të lëna nga procesi i akreditimit të parë, dhe nga ajo cka GVJ konstatoi gjatë vizitës në institucion dhe dokumentacionit të ofruar mund të themi se:

| | **Pikat përmbledhëse nga akreditimi i pare** | **Statusi aktual** |
|---|---|---|
| 1 | Departamenti duhet të shohë me përparësi kompletimin me staf mësimdhënës që zotëron të paktën gradën Doktor | Reflektuar |
| 2 | Të vazhdohet puna e nisur, sidomos me universitetet anglo saksone | Reflektuar |
| 3 | Të hartohet një plan kërkimi shkencor që reflekton kërkesat aktuale të biznesit dhe të administratës publike | Reflektuar |
| 4 | Kurikulat mësimore duhet të përcaktojnë qartë literaturën bazë të detyruar, pasi në disa lëndë ajo është e mbingarkuar | Reflektuar |
| 5 | Të pasurohet fondi i bibliotekës në veçanti me titujt e përfshirë në kurrikulat mësimore të lëndëve. | Reflektuar |

### II. ANALIZA PËRMBLEDHËSE E RVJ SIPAS METODËS SWOT (STRENGTHS-PIKAT E FORTA, WEAKNESSES- PIKAT E DOBËTA, OPPORTUNITIES-MUNDËSITË, THREATS-PENGESAT).

**a. Pika të forta:**

1) Disponibiliteti i një infrastrukture moderne.
2) Fokusi mbi përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë.
3) Strukturë organizative efektive.
4) Hartimi dhe përdorimi i një dokumentacioni ligjor dhe pedagogjik në nivelin e institucional dhe programor, dëshmon për një veprimtari të institucionalizuar dhe të standardizuar.
5) Sistemi LMS mbi bazën e të cilit studentët arrijnë të komunikojnë me stafin akademik lidhur me problematikat e ndryshme gjatë procesit mësimor.
6) Mbështetja që bën institucioni me anë të granteve lidhur me publikimet e stafit të tij (publikime të indeksuara në Skopus apo Thomson Reuters).
7) Mirëfunksionimi i zyrës së projekteve, që i jep mundësi stafit të informohet dhe të angazhohet në projekte të ndryshme.

**b. Pika të dobëta:**

1) Angazhimi i pedagogëve në shumë lëndë, ku stafi akademik ka raste që jep deri në **5** module të ndryshme.
2) Burime njerëzore të kufizuara, që ka sjellë një shpërndarje joefektive të lëndëve.
3) Shpërndarja e lëndëve jo gjithmonë në përputhje me fushën e ekspertizës së stafit akademik.
4) Udhëheqësit në këtë program studimi, mbikëqyrin një numër të madh studentësh njëkohësisht.
5) Vështirësi në diversifikimin e burimeve të financimit si institucion i vetëfinancuar në tregun shqiptar.

6) Pasurimi i zërave të bibliotekës me literaturë cilësore të viteve të fundit, në përputhje me lëndët që programi përmban, mbetet sfidë.
7) Mungesa e ofrimit të lëndëve të programit në gjuhë të huaj, do ti shërbente ndërkombëtarizimit të programit të studimit

**c. Mundësitë:**

1) Bashkëpunime të reja me aktorë brenda dhe jashtë vendit, për rritjen e reputacionit të programit dhe njohjen lokale dhe ndërkombëtare.
2) Interesimi në rritje i kompanive private dhe organizatave publike, për të rekrutuar studentët cilësorë.
3) Tradita e shqiptarëve përsa i përket arsimimit – popull arsimdashës – krijon shanse për zhvillimin e mëtejshëm të programit Master Profesional.
4) Marëveshjet e shumta me bizneset dhe bankat për realizimin e praktikave mësimore dhe mundësi punësimi për studentët.

**d. Pengesat:**

1) Ndryshimet e shpeshta të kuadrit ligjor, krijojnë problem në përshtatjen e institucioneve arsimore.
2) Mungesa e informacionit në tregun e punës lidhur me cilësinë dhe vlefshmërinë e diplomave të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë.
3) Tranzicioni i tejzgjatur i ekonomisë shqiptare çon në krijimin e një mjedisi jo shumë të qëndrueshëm dhe transparent.
4) Konkurrenca e lartë. Programi i studimit MP në Menaxhim Biznesi, ofrohet nga shumë konkurrente, universitete publike dhe private.
5) Mungesa e një studimi të mirëfilltë kombëtar për nevojat e tregut të punës për manaxherë biznesi.

**Grupi i Vlerësimit të Jashtëm**

Prof. Asoc. Etleva Leskaj

Prof. Asoc. Ana Kapaj

## SUMMARY ANALYSIS FOR THE EVALUATION OF THE STUDY PROGRAM

### III. SUMMARY ANALYSIS OF FULFILLMENT OF RECOMMENDATIONS FROM THE FIRST ACCREDITATION

The institution has received some recommendations from the first accreditation of the program "Professional Master" in "Business Management" with profiles. Based on these recommendations, HEI has worked continuously on their fulfillment. From all the recommendations left by the first accreditation process, and from what the external evaluation group, found during the visit in institution and the provided documentation, it is concluded that:

| | Recommendations from first accreditation | Actual status |
|---|---|---|
| 1 | The Department should consider the completion of the teaching staff with the PhD. Degree at least | Reflected |
| 2 | Continue the started work, especially with Anglo-Saxon universities | Reflected |
| 3 | Developing a scientific research plan, that reflects current business and public administration requirements | Reflected |
| 4 | Teaching curricula should clearly define mandatory core literature, because in some subjects it is overloaded | Reflected |
| 5 | Extend the library fund especially with the titles included in the curricula of teaching subjects | Reflected |

### I. SWOT SUMMARY ANALYSIS (STRENGTHS, WEAKNESSES- OPPORTUNITIES, THREATS).

**a. Strengths:**

1) The availability of a modern infrastructure
2) Focus on continuous improvement of quality
3) Effective organizational structure.
4) The compilation and use of legal and pedagogical documentation at the institutional and program level, demonstrates an institutionalized and standardized activity
5) The LMS system, on the basis of which students are able to communicate with the academic staf, about the various issues during the learning process.
6) Support by the institution through grants related to its staff publications (indexed publications in Scopus or Thomson & Reuters).
7) Functioning of the project office, which enables the staff to be informed and engaged in various projects.

**b. Weaknesses:**

1) Engagement of lecturers in many subjects, where academic staff has occasions that teaches up to 5 different modules.
2) Limited human resources, which has resulted in ineffective distribution of subjects
3) Distribution of subjects for academic staff, not always in line with the academic staff's field of expertise
4) Academic staff supervise a large number of students at the same time
5) Difficulties in diversifying sources of financing

6) Although the number of titles in the library has increased, the enrichment of library books with quality literature of recent years, in line with the subjects that the "Professional Master" program contains, remains a challenge.
7) Lack of foreign language courses. Offering of the program in a foreign language would serve the internationalization of the study program

**c. Opportunities:**

1) New collaborations with actors inside and outside the country, to increase the reputation of the program, and local and international recognition.
2) Increasing interest of private companies and public organizations, to recruit quality students
3) The tradition of Albanians in terms of education - educated people - creates opportunities for the further development of the program
4) Numerous agreements with businesses and banks for training practices and employment opportunities for students.

**d. Threats:**

1) Frequent changes to the legal framework create problems in adapting educational institutions.
2) Lack of information in the labor market regarding the quality and validity of diplomas offered by higher education institutions.
3) The prolonged transition of the Albanian economy leads to the creation of a not very stable and transparent environment.
4) High competition. The study program, "Professional Master" in "Business Management", is offered by many public and private universities.
5) Lack of national study for the needs of the labor market for business managers

**External Evaluation Group**

Prof.Asoc. Etleva Leskaj

Prof.Asoc.Ana Kapaj

**ANEKSE**

***Tabelat 2.1***: Numri i Personelit Akademik Efektiv (PAE) dhe me kontratë (PAK) në rang Fakulteti dhe në rang Departamenti për vitin **2016-2017**

| Fakulteti Ekonomik dhe i Teknologjisë së Informacionit | Numri i PAE | | Numri i PAK | | | | Nr. PA |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Viti akademik **2016-2017**** | Gj | Tituj/ Grada | Gj | Tituj/ Grada | Gj | Tituj/ Grada | Gjithsej |
| Departamenti i Financës dhe Ekonomiksit | 22 | 13 | 10 | 8 | 32 | 21 | |
| Departamenti i Menaxhimit dhe Marketingut | 11 | 8 | 6 | 6 | 17 | 14 | |
| Departamenti i Informatikës, Matematikës dhe Statistikës | 12 | 4 | 22 | 14 | 34 | 18 | |
| **Në total** | **45** | **25** | **38** | **28** | **83** | **53** | **68 *** |

***Tabelat 2.2***: Numri i Personelit Akademik Efektiv (PAE) dhe me kontratë (PAK) në rang Fakulteti dhe në rang Departamenti për **2017-2018**

| Fakulteti Ekonomik dhe i Teknologjisë së Informacionit | Numri i PAE | | Numri i PAK | | Gjithsej | | Nr. PA |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Viti akademik **2017-2018 **** | Gj | Tituj/ Grada | Gj | Tituj/ Grada | Gj | Tituj/ Grada | Gjithsej |
| Departamenti i Financës dhe Ekonomiksit | 23 | 14 | 7 | 5 | 30 | 19 | |
| Departamenti i Menaxhimit dhe Marketingut | 13 | 11 | 5 | 4 | 18 | 15 | |
| Departamenti i Informatikës, Matematikës dhe Statistikës | 16 | 4 | 18 | 10 | 34 | 14 | |
| **Në total** | **52** | **29** | **30** | **19** | **82** | **48** | **52*** |

* Personeli administrativ është dhënë në nivel institucional pasi nuk është i ndarë sipas njësive

** Marrë nga RVB.

***Tabelat 3.1:*** Personeli Akademik Efektiv (PAE) dhe me Kontratë (PAK) **për Departamentin e Menaxhimit dhe Marketingut** për vitin akademik **2016 - 2017**

| **Stafi akademik për Departamentin e Menaxhimit dhe Marketingut (Viti Akademik 2016-2017)*** | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| Personeli Akademik Efektiv | | Titulli/Grada | Personeli Akademik me Kontratë | | Titulli/Grada | Institucioni ku punon full time |
| 1 | Drita Kruja | Prof. Dr. | 1 | Edlira Gjuraj | Prof. Asoc. Dr | Nuk është e punësuar |
| 2 | Oltjana Zoto | Prof. Asoc. Dr. | 2 | Edlira Margilaj | Dr. | Autoriteti i Aviacionit Civil |
| 3 | Arlinda Ymeraj | Prof. Asoc. Dr. | 3 | Evis Gjebrea | Dr. | Ujësjellës Kanalizime Tiranë Sh.a. |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 4 | Ermira Qosja | Prof. Asoc. Dr. | 4 | Besarta Vladi | Dr. | Fondacioni Shqiptaro-Amerikan për Zhvillim (AADF) |
| 5 | Kreshnik Bello | Prof. Asoc. Dr. | 5 | Denisa Mamillo (sem 2) | Dr. | Bashkia Përmet |
| 6 | Ani Mbrica | PhD. | 6 | Nikolaq Pano | Dr. | SHLP Mesdhetare e Shqipërisë |
| 7 | Elena Kokthi | Dr. | | | | |
| 8 | Elvira Tabaku | Dr. | | | | |
| 9 | Denisa Mamillo (sem 1) | Dr. | | | | |
| 10 | Ertila Druga | MSc. | | | | |
| 11 | Grisilda Miftari | MSc. | | | | |
| 12 | Eliona Zhonga | MSc. | | | | |

***Tabelat 3.2:*** Personeli Akademik Efektiv (PAE) dhe me Kontratë (PAK) **për Departamentin e Menaxhimit dhe Marketingut** për vitin akademik **2017-2018**

| **Stafi akademik për Departamentin e Menaxhimit dhe Marketingut (Viti Akademik 2017-2018)*** | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| Personeli Akademik Efektiv | | Titulli/Grada | Personeli Akademik me Kontratë | | Titulli/Grada | Institucioni ku punon full time |
| 1 | Drita Kruja | Prof. Dr. | 1 | Edlira Gjuraj | Prof. Asoc. Dr | Fondi Shqiptar i Zhvillimit |
| 2 | Oltjana Zoto | Prof. Asoc. Dr. | 2 | Edlira Margilaj | Dr. | Autoriteti i Aviacionit Civil |
| 3 | Arlinda Ymeraj | Prof. Asoc. Dr. | 3 | Evis Gjebrea | Dr. | Ujësjellës Kanalizime Tiranë Sh.a. |
| 4 | Ermira Qosja | Prof. Asoc. Dr. | 4 | Denisa Mamillo | Dr. | Bashkia Përmet |
| 5 | Kreshnik Bello | Prof. Asoc. Dr. | 5 | Emi Dautaj | MSc. | Fondi Shqiptar i Zhvillimit |
| 6 | Ani Mbrica | PhD. | | | | |
| 7 | Ledina Alolli | Prof. Asoc. Dr. | | | | |
| 8 | Irina Canco | PhD. | | | | |
| 9 | Besarta Vladi | Dr. | | | | |
| 10 | Ertila Druga | Msc. | | | | |
| 11 | Elena Kokthi | Dr. | | | | |
| 12 | Elvira Tabaku | Dr. | | | | |
| 13 | Grisilda Miftari | MSc. | | | | |

* Marrë nga RVB.

***Tabelat 3.3*** : Personeli Akademik Efektiv (PAE) dhe me Kontratë (PAK) **për Programin e studimit MP në "Menaxhim Biznesi", me profile: "Menaxhim i SME-ve"; "Menaxhim i Burimeve Njerezore dhe Karrieres"; "Institucioneve dhe Administrim Publik"**, në vitet akademike **2011-2012, 2012-2013, 2013-2014, 2014-2015, 2015-2016, 2016-2017** dhe **2017-2018***

| **Stafi akademik për Programin e studimit MP në Menaxhim Biznesi, 3 profile (Viti Akademik 2011-2012)** | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| Personeli Akademik Efektiv | | Titulli/Grada | Personeli Akademik me Kontratë | | Titulli/Grada | Institucioni ku punon full time |
| 1 | Ermira Qosja | Dr. | 1 | Aleksandër Biberaj | Dr. | Universiteti Politeknik i Tiranës |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 2 | Edlira Gjuraj | Dr. | 2 | Gavril Lasku | Doktorant | Agjencia e Nxitjes së Zhvillimit të Ndërmarrjeve të Vogla e të Mesme |
| 3 | Arben Bakllamaja | Dr. | | | | |
| 4 | Herion Ndreka | Doktorant | | | | |
| 5 | Petraq Papajorgji | Prof. Dr. | | | | |
| 6 | Indrit Baholli | Dr. | | | | |
| 7 | Magdalena Bregasi | Prof. As. Dr. | | | | |
| 8 | Aleksandër Dhima | Prof. As. Dr. | | | | |

| **Stafi akademik për Programin e studimit MP në Menaxhim Biznesi, 3 profile (Viti Akademik 2012-2013)** | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| Personeli Akademik Efektiv | | Titulli/Grada | Personeli Akademik me Kontratë | | Titulli/Grada | Institucioni ku punon full time |
| 1 | Ermira Qosja | Dr. | 1 | Aleksandër Biberaj | Prof. Asoc. Dr. | Universiteti Politeknik i Tiranës |
